



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR**  
**TIRANË**

**Nr.31 Regj.Them.**  
**Dt. Regj. 09.06.2023**

**Nr. 28 Vendimi**  
**Dt.15.06.2023 Vendimi**

**V E N D I M**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në trup gjykues të përbërë nga:

<b>Gjyqtare:</b>	<b>Esmeralda XHILI</b>	<i>(Relatore)</i>
<b>Gjyqtare:</b>	<b>Edlira PETRI</b>	<i>(Anëtare)</i>
<b>Gjyqtare:</b>	<b>Emona MUÇI</b>	<i>(Anëtare)</i>
<b>Gjyqtare:</b>	<b>Blerona HASA</b>	<i>(Anëtare)</i>
<b>Gjyqtare:</b>	<b>Marsela DERVISHI</b>	<i>(Anëtare)</i>

me sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, sot më datë 15.06.2023, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen Nr.31Akti Dt.09.06.2023 me:

**PADITËSA:** - Koalicioni “BASHKË FITOJMË”, me adresë: Rr.“Sami Frashëri”, Godina 20/10, Tiranë, përfaqësuar nga Z.Franci Nuri.  
- Shkëlqim Hoxha, kandidati për kryetar bashkie i Bashkisë Rrogozhinë, përfaqësuar nga Av.Viktor Gumi.

**I PADITUR:** - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Znj.Ina Osmanaj, Z.Blendi Kodra dhe Z.Erdal Mema.

**PERSON I INTERESUAR:** Subjekti Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, me adresë: Sheshi "Austria", Nr.91, Tiranë, përfaqësuar nga Av.Maringlen Legisi dhe Z.Eridian Salianji.

**OBJEKTI:** - Ndryshimin e Vendimit Nr.174 Dt.06.06.2023 të Komisionit për Ankimimet dhe Sanksionet (KAS), pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.  
- Miratimin e “Tabelës së re përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për kryetar Bashkia Rrogozhinë”, duke mos përfshirë rezultatin zgjedhor të Qendrës së Votimit Nr.2224/1, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEPV) Rrogozhinë.  
- Shpalljen fitues për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, Z.Shkëlqim Hamid Hoxha, propozuar nga subjekti zgjedhor “Bashkë Fitojmë”.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 145, 152, 153, 155 e vijues të Kodit Zgjedhor.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, zhvilluar në prani të palëve ndërgjyqëse:

- Pala paditëse kërkoi pranimin e kërkespadiisë, sipas objektit;
- Pala e paditur kërkoi rrëzimin e kërkespadiisë;
- Personi i interesuar kërkoi rrëzimin e kërkespadiisë.

## KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR

referuar pretendimeve dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqëse dhe akteve provuese të dorëzuara në funksion të tyre:

### VËREN

1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin Nr.13864 Dt.24.10.2022, ka caktuar zhvillimin më datë 14 Maj 2023, të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

2. Koalicioni “Bashkë Fitojmë”<sup>1</sup> rezulton subjekt zgjedhor i regjistruar pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, ndërsa paditësi Shkëlqim Hoxha rezulton kandidat i Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për kryetar në Bashkinë Rrogozhinë.

3. Në datën 14.05.2023, në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, respektivisht në 61 bashki.

4. Zona zgjedhore Bashkia Rrogozhinë rezulton të ketë pasur një zonë të administrimit zgjedhor (ZAZ), identifikuar si ZAZ Nr.43.

5. KZAZ-ja Nr.43, më datë 17.05.2023, rezulton të ketë informuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve mbi pamundësinë e disponimit të vendimit të miratimit të tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë dhe shpalljes së fituesit, pavarësisht përfundimit të procesit të numërimit të votave më datë 16.05.2023, për shkak të mungesës së kuorumit (katër vota kundër nga shtatë anëtarë komisioni), bazuar në ankesën e përfaqësuesve të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” dhe kandidatit Shkëlqim Hoxha.

6. Për këtë shkak, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në Nenin 35 të Kodit Zgjedhor, rezulton të ketë disponuar Vendimin Nr.531 Dt.18.05.2023, që konsiston në:

*“1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.*

*2. Shpalljen fitues për Kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, z.Edison Selman Memolla, të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë”.*

7. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve rezulton të ketë argumentuar se:

*“10.1 Zona zgjedhore Bashkia Rrogozhinë ka 1 (një) zonë të administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ nr.43.*

*10.2 Në referim të nenit 122, pika 3 të Kodit Zgjedhor, Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së, miratohet me vendim të KZAZ-së. KZAZ nr.43 nuk ka*

<sup>1</sup> Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 178, datë 18.03.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, (BF), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin ka vendosur: l.Regjistrimin e Koalicionit “BASHKË FITOJMË” (PL-PDK-PBDNJ), “BF”, si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, me parti pjesëtare të tij si më poshtë:a) “Partia e Lirisë” (PL);b) “Partia Demokratiane e Shqipërisë” (PDK);c) “Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut” (PBDNJ).

miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë.

10.3 Në këtë rast, veprohet në përputhje me nenin 35 pika 5 të Kodit Zgjedhor sipas të cilit, në rast se KZAZ-ja nuk arrin të marrë vendim brenda afatit përkatës, çështja i dërgohet brenda 24 (njëzet e katër) orëve për shqyrtim KQZ-së nga kryetari i KZAZ-së ose të paktën nga dy anëtarë, ose mund të ankimohet në KQZ nga subjekti zgjedhor i interesuar. Një kopje e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve dhe tabelave të rezultateve për çdo qendër votimi, dërgohet menjëherë në KQZ, përfshirë edhe rrugët elektronike të komunikimit.

10.4 Zëvendëskryetari dhe një anëtar i KZAZ kanë sjellë informacionin për mosmiratimin e Tabelës Përmbledhëse të Resultatit të zonës Zgjedhore për kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë.

10.5 Në kushtet kur KZAZ nuk ka marrë vendim, çështja i kalon për vendimmarrje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

10.6 Gjatë verifikimit të Tabelës Përmbledhëse të Resultatit të zonës zgjedhore për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë, rezultoi se: Në tabelat përmbledhëse janë përfshirë rezultatet e të gjitha qendrave të votimit në juridiksionin e KZAZ 43, Bashkia Rrogozhinë, Qarku Tiranë.

10.7 Nga verifikimi i kryer, tabela e rezultateve të zgjedhjeve të ZAZ nr.43, është plotësuar duke pasqyruar rezultatin e çdo kutie të numëruar dhe atë të votave të hedhura gabim.

10.7 Nuk rezulton asnjë mospërputhje ndërmjet tabelës përmbledhëse të rezultateve të zgjedhjeve dhe tabelës së rezultateve të votimit të plotësuar nga GNV.

10.8 Tabela Përmbledhëse e Resultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, Qarku Tiranë, mbështetet në origjinalet e tabelave të rezultateve të çdo qendre votimi të kësaj Bashkie, të plotësuar nga Grupi i Numërimit të Votave”.

8. Pala paditëse e ka kundërshtuar Vendimin Nr.531 Dt.18.05.2023 të Komisionerit, nëpërmjet Kërkesës Ankimore Dt.23.05.2023, duke kërkuar miratimin e tabelës së re përmbledhëse, pas rinumërimit dhe rivlerësimit të votave në të gjitha qendrat e votimit të zonës zgjedhore Bashkia Rrogozhinë dhe heqjes së rezultatit zgjedhor të Qendrës së Votimit Nr.2224/1, IEVP Rrogozhinë, bazuar në arsyetimin se:

“6.Rezultati Zgjedhor për Kryetar të Bashkisë Rrogozhinë rezulton se është shumë i ngushtë mes dy kandidatëve konkurrues (vetëm 30 vota) ndërkohë që numri i votave të pavlefshme për këtë zonë zgjedhore në votimin për kryetar të Bashkisë është 276 vota pra më shumë se 9 herë më e madhe se diferenca e votave mes dy kandidatëve.

Për këtë shkak dhe në funksion të legjitimitetit të plotë demokratik që duhet të kenë organet e dala nga zgjedhje të drejtpërdrejta, të lira dhe të ndershme është me rëndësi rinumërimi dhe rivlerësimi jo vetëm i 276 votave të pavlefshme por në përgjithësi i të gjithë qendrave të votimit. Rinumërimi dhe rivlerësimi i të gjitha votave do të jetë përgjigje përfundimtare për çdo gabim të mundshëm dhe/ose të qëllimshëm njerëzor që nëse ka ndodhur ka passjellë këtë rezultat shumë të ngushtë zgjedhor.

Sa më sipër paraqitet ankimi me objekt rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në të gjithë zonën zgjedhore Bashkia Rrogozhinë si e vetmja mënyrë për të hequr çdo mëdyshje në rezultat dhe për të formuar legjitimitet të plotë dhe të padiskutueshëm për zgjedhjen e kryetarit të ri të Bashkisë Rrogozhinë.

7.Një mësim i nxjerrë nga historiku i zgjedhjeve në Shqipëri është se sistemet dhe mekanizmat testohen sa herë është rezultati i ngushtë i zgjedhjeve mes kandidatëve. Rasti i Bashkisë Rrogozhinë-votimi për kryetar të saj-është një prej rasteve më domethënëse në të cilën rezultati i ngushtë zgjedhor mund të vijë edhe si pasojë e gabimit njerëzor të çfarëdollojshëm në vlerësimin e votës. Ndaj për këtë arsye është me vend dhe të kërkojmë të

kryhet rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për kryetar bashkie në të gjithë zonën zgjedhore përkatëse.

8.Nga ana tjetër, këtë zonë zgjedhore janë konsumuar edhe shkelje të ligjit zgjedhor në procesin e numërimit dhe vlerësimit ku pothuajse për shumicën e qendrave të votimit të numëruara rezultati i dalë dhe i pasqyruar në tabelat e numërimit nuk pasqyron saktësisht rezultatin e vërtetë. Kjo është konstatuar nga ana jonë nga krahasimi i rezultateve të mbajtura nga vëzhguesit tanë me ato të tabelave të secilit grup të numërimit të votave të cilat për shkak se tabuloheshin dhe hidheshin në sistem me vonesë na viheshin në dispozicion me vonesë si subjekt zgjedhor. Fenomene të tilla të vlerësimit dhe tabelimit të gabuar në rezultat të votave për kryetar të Bashkisë kanë ndodhur në qendrën e votimit nr.2232, nr.2212, nr.2224.

9.Duke marrë shkak nga të dhënat e vëzhguesve dhe të numëruesve në grupet e numërimit të votave, Ankimuesi kërkon marrjen e provës nga KQZ të pajisjeve me regjistrimet e kamerave të procesit të numërimit në ZAZ-42 për të cilën ka paraqitur në KQZ paraprakisht kërkesë me shkrim. Nga verifikimi i këtyre pamjeve filmike do të rezultojë se numri i votave të vlefshme të kandidatit Shkëlqim Hoxha të cilat janë vlerësuar si të pavlefshme ose nuk janë përfshirë në numrin e votave të vlefshme të tij, është relativisht i lartë. Për pasojë natyra e shkeljeve të pretenduara në procesin e leximit dhe vlerësimit të votës e bëjnë të detyrueshme rinumërimin dhe rivlerësimin ku nga informacionet që disponojmë konstatohet qartë se vota për Ankuesin është shpërdoruar dhe për pasojë nuk është vlerësuar në mënyrë korrekte nga grupet e numërimit.

10. Në zgjedhjet e zhvilluara në 14 maj 2012 për kryetar në Bashkinë Rrogozhinë diferenca midis kandidatit të koalicionit “ Bashkë Fitojmë” Ankimues dhe kandidatit të subjektit Partia Socialiste, ishte në favor të kandidatit Shkëlqim Hoxha me 57 vota deri në momentin kur u hap kutia e fundit ajo e qendrës së votimit nr.2224/1 IEVP Rrogozhinë që rezultoi edhe kutia e votimit që i dha fitoren dhe kandidatit të PS-së me një diferencë prej 30 votash...

11. Kodi Zgjedhor parashikon se, Nenet 165, Kodi Civil Nenet 12 dhe 14, Ligji nr.10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, Neni 18...

12. Vendimi nr.40, datë 16.11.2007 i Gjykatës Kushtetuese...

13.Qartazi ka një mospërputhje mes formulimeve të bëra në Kodin Zgjedhor dhe Kodin Civil me nenin 18 të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”. Përparësinë e zbatimit të drejtpërdrejtë të ligjit në një hierarki më të lartë normative e përcakton qartë jurisprudenca kushtetuese, Vendimi nr.2, datë 03.02.2010, nr.19, datë 03.05.2007...

14. Kodi Civil dhe Kodi Zgjedhor janë ligje organike që miratohen me jo më pak se tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit sipas neneve 6 dhe 81 pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës, ndërsa ligji “Për gjendjen civile” miratohet me shumicë të thjeshtë të votave nga Kuvendi.

15.Jurisprudenca i ka dhënë zgjedhje konfliktit që krijohet mes ligjeve duke pranuar përparësinë që kanë ligjet që miratohen me shumicë të cilësuar kundrejt ligjeve që miratohen me shumicë të thjeshtë. Në çështjen konkrete ligji i vetëm i zbatueshëm është Kodi Civil dhe Kodi Zgjedhor dhe jo ligji “Për gjendjen Civile” neni 18 i tij.

16.Për të përdorur terminologjinë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese zgjedhjet vendore janë një lidhje më e ngushtë midis zgjedhësit dhe të zgjedhurit për vetë natyrën e organizimit dhe kompetencave të pushtetit vendor. Është pushteti vendor që kujdeset për zgjidhjen e problemeve aktuale të qytetarëve që lidhen me çështje të tilla si punësimi, kujdesi shëndetësor, arsimiti parashkollor, pastrimi dhe gjelbërimi i mjediseve të njësisve vendore etj. Kushti për të pasur vendbanimin-sipas Kodit Civil dhe Kodit Zgjedhor-në zonën zgjedhore përkatëse është një nga kufizimet e të drejtës së votës e cila bashke me kriterin e shtetësisë synojnë të vendosin një lidhje direkte qoftë edhe minimale midis votuesit dhe rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Vetëm në këtë mënyrë sigurohet legjitimiteti i votës në një zonë të

caktuar.

17. Personat e dënuar me vendim të formës së prerë apo me paraburgim duhet të ushtrojnë të drejtën e votës në vendim që kanë vendbanimin në kuptim të kodit Civil. Po sipas Kodit civil institucioni i vuajtjes së dënimit ose paraburgimit është institucion vendqëndrimi dhe kurrsesi vendbanimi. Sipas përkufizimit të Kodit Civil vendbanimi është i ndryshëm si institut me vendqëndrimin. Nëse do të shtojmë se vendqëndrimi kthehet në vendbanim nëse psh qëndrohet në të jo më pak se 3 muaj, përçundojmë institutin civil të vendbanimit sepse dallimi mes tyre nuk është aspak dhe vetëm kriter kohor. Ndaj në terma praktikë personat që vuajnë dënimin penal/të paraburgosur duhet të ushtrojnë të drejtën e votës dhe të llogaritet vota e tyre në rezultatin e vendbanimit të tyre sipas Kodit Civil dhe jo në bashkinë që përfshin institucionin e vuajtjes së dënimit.

18. Edhe në zgjedhjet më të fundit 14 maj 2023 ka praktikë gjyqësore si psh vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me nr.52 akti, datë 04.05.2023 e cila vendosi se votimi i një të burgosuri nuk është vendi i vuajtjes së dënimit sepse ai përbën vendqëndrimin e tij, por vendi i banimit të tij sipas përcaktimit që bën Kodi Civil dhe Kodi Zgjedhor.

19. Rezultati i votimit për Kryetar të Bashkisë së Rrogozhinës bëhet akoma më paradoksal sepse kutia e fundit në numërim-qendra nr.2224/1 Burgu i Rrogozhinës që i dha fitoren kandidatit tjetër-sipas informacionit që kemi, ka vetëm dy shtetas shqiptar me vendbanim në Bashkinë e Rrogozhinës sipas kriterit të përcaktuar në Kodin Civil.

20. Instituti i vendbanimit dhe ai i vendqëndrimit janë institute të së drejtës civile të parashikuar në Kodin Civil. Parashikimi që bën Kodi Civil shqiptar për to është i njëjtë me parashikimet e Kodit Civil Italian. Në asnjë rresht në Kodin Civil nuk është bërë delegimi për t'u përcaktuar me ligj se kur një vendqëndrim shndërrohet në vendbanim ashtu siç e ka realizuar neni 18 i ligjit "Për gjendjen civile". Neni 12 dhe neni 14 i Kodit Civil nuk janë me formulime si dispozitë deleguese kur një gjë e tillë është dashur, Kodi Civil e ka bërë në mënyrë të shprehur psh me formulimin e neneve 38, 152, 163...

21. Pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Rrogozhinë është ngritur qendra e votimit nr.2224/01 dhe lista e zgjedhësve për këtë qendër votimi është 119 persona që vuajnë dënimin në këtë I EVP. Nëpërmjet hartimit, miratimit dhe votimit sipas listës së zgjedhësve në këtë I EVP realizohet krijimi i një marrëdhënieje juridike të caktuar. Ndjekja nga ana e organit administrativ gjatë procesit urdhërdhënës të qëllimeve të ndryshme nga ato të vet ligjit do të ndikonte drejtpërdrejt në vlefshmërinë e aktit. Kusht i domosdoshëm që lista e zgjedhësve në I EVP Rrogozhinë të krijojë efektet juridike është vlefshmëria e saj. Sipas të drejtës sonë administrative organi i cili nxjerr aktin mund të ndjekë qëllime të mira dhe të cilat janë në favor të interesit të përgjithshëm por përsëri qëllimi i aktit nuk konsiderohet i ligjshëm për shkak të mospërputhjes së tij me qëllimin e ligjit. Hartimi i listës së zgjedhësve për të votuar në I EVP Rrogozhinë është i qëllimshëm dhe ndjek interesin e përgjithshëm për të mundësuar të drejtën e votës por mbetet përsëri akt juridikisht i pavlefshëm sepse është bërë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kodin Zgjedhor, në Kodin Civil dhe në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

22. I gjithë qëllimi i korpusit ligjor në Shqipëri përfshirë Kushtetutën dhe krijimi i institucioneve që merren më zgjedhjet në vend është të krijojnë dhe mundësojnë zhvillimin e zgjedhjeve të lira të drejta dhe të ndershme si dhe në përputhje me standardet ndërkombëtar. Rezultati zgjedhor duhet të jetë i tillë që të respektojë të gjitha kushtet e përmendura më lart.

Ka një pyetje qendore të cilës duhet t'i japim përgjigje: A është e drejtë, e ndershme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare që kryetari i bashkisë të përcaktohet vetëm nga vota e të burgosurve? Për më tepër kur janë vetëm dy shtetas që vuajnë dënimin në atë burg, me vendbanim në këtë Bashki, por që nuk janë lejuar të votojnë sipas informacioneve që posedojnë?



23. Kjo është një pyetje që shtrohet për herë të parë në vend dhe para KAS-it në këto zgjedhje. Mbetet të shohim përgjigjen që do të japin për këtë kërkesë institucionet shqiptare. Por nëse i referohemi praktikës ndërkombëtare pyetja që parashtruar ka një përgjigje. Mbretëria e Bashkuar është një prej vendeve që ka shkaktuar debat të fortë juridik në nivelin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për çështjen e së drejtës së votimit të të burgosurve (çështjet *Hrist v Mbretërisë së Bashkuar, Greens dhe M.T v Mbretërisë së Bashkuar, Mclean dhe Cole v Mbretërisë së Bashkuar, Dunn dhe të tjerët v Mbretërisë së Bashkuar, Firth dhe të tjerët v Mbretërisë së Bashkuar, McHugh dhe të tjerët v Mbretërisë së Bashkuar etj*). Edhe i ashtëquajtura ligji shqiptar “Për dekriminalizimin” (ligji nr.138/2015) mbështetet në modelin e zhvilluar në Mbretërinë e Bashkuar.

24. Në datën 20 janar 2023 shërbimet e House of Commons paraqitën një kërkim shkencor në lidhje me çështjen e votimit të të burgosurve një pjesë e të cilit i dedikohet votës së të burgosurve në zgjedhjet vendore. Në këtë studim posaçërisht për këtë çështje theksohet se: “ të burgosurit do të regjistroheshin për të votuar duke deklaruar lidhjen lokale me një të adresë të mëparshme ose autoritet lokal, në vend të adresës së burgut. Kjo do të shmangte mundësinë që një numër i madh i të burgosurve, të regjistruar në burg të shkaktojë shtrembërim për numrin e votuesve dhe rezultatin elektoral veçanërisht për zgjedhjet lokale skoceze me madhësi më të vogla të njëjësive...”.

9. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në përfundim të shqyrtimit të ankimit, rezulton të ketë disponuar Vendimin Nr.174 Dt.06.06.2023, që konsiston në:

“1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore nr.80, datë 23.05.2023, të depozituar nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

2. Ndryshimin e vendimit nr.531, datë 18.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, sipas tabelës përmbledhëse të miratuar me vendimin e ndërmjetëm të KAS të datës 05.06.2023.

3. Rrëzimin e kërkesës për mospërfshirjen në Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023 të rezultatit të zgjedhjeve për Qendrën e Votimit nr.2224/01, I EVP Rrogozhinë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor”.

10. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve rezulton ta ketë bazuar vendimin, në arsyetimin se:

“1. Procedura e votimit dhe ajo e numërimit të votave janë procedura transparente dhe të dokumentuara në çdo hap. Kodi Zgjedhor është kujdesur që ato të zhvillohen në sytë e përfaqësuesve të subjekteve, vëzhguesve të pavarur dhe të publikut, si dhe çdo problem, parregullsi apo shkelje e ligjit të dokumentohet në procesverbalet tip dhe librat e protokollit të komisioneve përkatëse, si dhe të filmohet nga kamerat mbikëqyrëse të procesit, me qëllim që të shërbejë si provë materiale në proceset eventuale për kundërshtimin e rezultatit apo të zgjedhjeve në tërësi.

2. Dokumentacioni që prodhohet nga administrata zgjedhore gjatë zbatimit të procedurave të votimit dhe të numërimit të votave bën pjesë në radhën e parë dhe kryesore të provave ku mund të mbështeten kërkesat ankimore me objekt ndryshimin e Tabelës

*Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi. Subjektet zgjedhore kanë akses mbi këtë dokumentacion, në disa raste disponojnë ipso lege kopje të tij.*

*Nga ana tjetër, Kodi Zgjedhor u njeh palëve edhe të drejtën për të vënë në lëvizje KQZ-në për marrjen e provave “për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre, duke paraqitur njëkohësisht edhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur sigurimi i tyre”.*

*3. Pika 1, e nenit 82 të K.Pr.A saktëson: “në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej tij”. Këtë detyrim e vendos edhe Kodi Zgjedhor nëpërmjet shkronjës “b” të pikës 1, të nenit 136, kur u kërkon palëve “të tregojnë faktet dhe provat, mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre”.*

*4. Kodi Zgjedhor kërkon në mënyrë të shprehur që pretendimet të jenë të mbështetura në prova, sepse Kodi kërkon që t’i presë rrugën e suksesit kërkimeve të pathemelta ose me ves. Kjo do të thotë, se Kodi kërkon që raporti midis pretendimit dhe provës të jetë i drejtpërdrejtë, thënë ndryshe, prova duhet të shërbejë për të mbështetur drejtpërdrejt pretendimin. Pika 4 e nenit 136 të Kodit Zgjedhor saktëson, se “KQZ-ja mund të refuzojë kërkesën e ankuesit apo të palës së interesuar për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 dhe pikës 2 të këtij neni, vetëm nëse vlerëson se prova nuk shërben për të vërtetuar faktet e pretenduara”. Nga ana tjetër, kjo do të thotë se në raportin midis provës dhe pretendimit, prova vjen e para. Provat ekzistojnë përpara pretendimit, nuk krijohen për shkak të tij.*

*5. Kodi Zgjedhor njeh rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave përgjatë procedurës ankimuese, por Kodi e pranon rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave vetëm për vota të caktuara dhe vetëm në rrethana tejet specifike. Vota të caktuara janë, sipas pikës 3 të nenit 138 të Kodit Zgjedhor, “votat e identifikuar ose të kontestuara, sipas procedurave të neneve 116 dhe 118 të këtij Kodi, për të cilat është kontestuar vlerësimi ose numri i tyre gjatë procesit të numërimit, si dhe votat e tabelës së rezultatit të kundërshtuar, sipas pikës 2 të nenit 119 të këtij Kodi”. Kjo do të thotë se numërimi dhe/ose vlerësimi i votave duhet të jenë shoqëruar me kontestime apo me konstatimin e pasaktësive, për to duhet të jenë bërë shënimet përkatëse në fletët e kontestuara, në tabelën e rezultateve të kontestuara apo në librin e protokollit të KZAZ-së, me qëllim që ato të mund t’i nënshtrihen procedurës së rinumërimit dhe/ose rivlerësimit.*

*6. Neni 116 i Kodit Zgjedhor përcakton se kur shifra e totalit të fletëve të votimit të gjetura në kuti nuk përputhet me shifrën për pjesëmarrjen e zgjedhësve të shënuar në Procesverbalin e Mbylljes së Votimit, atëherë KZAZ-ja e pasqyron pasaktësinë në Procesverbalin e Konstatimit. Neni 118 përcakton procedurën e administrimit të fletëve të kontestuara, të cilat, pas kontestimit, rivlerësohen nga GNV-ja dhe, nëse kontestimi mbahet në këmbë, vlerësohen nga KZAZ-ja. Rezultati i shpallur shënohet në librin e protokollit të KZAZ-së dhe përfshihet në tabelën përkatëse të rezultatit të qendrës së votimit që harton grupi i numërimit të votave. Për secilën fletë të kontestuar, në pjesën e prapme të saj numëruesi i parë i Grupit të Numërimit shënon qartë arsyet e kontestimit. Për votat e kontestuara mbahet një procesverbal i veçantë, në të cilin pasqyrohet numri i përgjithshëm i fletëve të votimit të kontestuara për QV-në përkatëse. Në përfundim të nxjerrjes së rezultatit, fletët e votimit të kontestuara dhe procesverbali përkatës futen në zarfin e “FLETËVE TË VOTIMIT TË KONTESTUARA”. Neni 119 përcakton se kur ka kontestime për tabelën e rezultateve për qendrën votimit që harton GNV-ja, kontestimet e anëtarëve të GNV-së shënohen në tabelë, kurse kontestimet e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore shënohen në librin e protokollit të KZAZ-së.*

*7. Pika 3 e nenit 136 të Kodit Zgjedhor përcakton se secili anëtar i KAS-it ka të drejtë të kërkojë dhe KAS-i është i detyruar të kryejë rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave të*

caktuara, por kjo e drejtë nuk mund të ushtrohet në mënyrë arbitrare apo voluntariste. Si kur rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e kërkojnë anëtarët e veçantë, ashtu dhe kur e kërkojnë palët, përpara se të vendoset rinumërimi dhe/ose rivlerësimi i votave të caktuara duhet të merret dhe administrohet prova përkatëse e kontestimit, sepse sipas nenit 136 të Kodit Zgjedhor pa kontestim nuk ka rinumërim dhe/ose rivlerësim. Nëse kërkohet rinumërimi i totalit të votave të hedhura në kuti, për shkak se janë konstatuar pasaktësi, atëherë duhet të merret dhe administrohet paraprakisht Procesverbali i Konstatimit. Nëse kërkohet rivlerësimi i votave të kontestuara, atëherë duhet të merret dhe administrohet paraprakisht libri i protokollit të KZAZ-së me shënimet për rezultatin e shpallur për votat e kontestuara. Nëse kërkohet rinumërim dhe/ose rivlerësim tërësor ose pjesor i votave të qendrës së votimit, atëherë duhet të merret dhe administrohet paraprakisht tabela e rezultateve për qendrën votimit me shënimin kundërshtues të anëtarit të GNV-së dhe libri i protokollit i KZAZ-së me shënimin kundërshtues të vëzhguesit të subjektit zgjedhor.

8. Rinumërimi dhe/ose rivlerësimi i votave nuk bëhet pa procedurë paraprake kontestimi. Kjo do të thotë se nuk mund të ketë rinumërim dhe/ose rivlerësim thjesht dhe vetëm për shkakun se diferenca e votave midis dy kandidatëve konkurrues është më e vogël se numri i votave të pavlefshme. Rinumërimi ipso lege ka qenë njohur nga Kodi Zgjedhor në formatin e tij fillestar të vitit 2000, por ligjvënësi hoqi dorë shpejt nga ky modalitet. Kërkesa për rinumërim për diferencë të ulët votash sot është pa bazë ligjore. Po kështu, nuk mund të ketë rinumërim dhe/ose rivlerësim për shkak të pretendimit se rezultati i votimit duket “i panatyrshëm”, “i çuditshëm”, “i paarsyeshëm”, “i pabesueshëm”, apo bazuar në ‘dyshime të arsyeshme’ se mund të ketë pasur gabime, pasaktësi, parregullsi apo devijime në tabulim. Rinumërimi dhe/ose rivlerësimi i votave nuk mund të bëhet thjesht dhe vetëm për shkak se vëzhguesit e subjektit kanë tabuluar rezultat të ndryshëm nga rezultati i tabuluar nga GNV-të, apo për shkakun se ata nuk ka në qenë të pranishëm në procedurën e numërimit fillestar. Pretendimet e vëzhguesve të subjektit nuk formojnë provë dhe prania e tyre në numërim nuk është kusht për vlefshmërinë e numërimit. Vëzhguesit janë pjesë e subjektit dhe pretendimet e tyre, ashtu si çdo pretendim tjetër i subjektit duhet të provohen nga ankuesi, përpara se çështja të marrë zgjidhje ligjore.

9. Sipas nenit 136 të Kodit Zgjedhor, marrja e provës ex officio bëhet në dy raste, kur palët “kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre, duke paraqitur njëkohësisht edhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur igrurimi i tyre” (shkronja “c” e pikës 1 të nenit 136), si dhe kur vetë KAS-i “çmon se marrja e tyre është në dobi të gjykimit” (pika 2 e nenit 136). Qëllimi i hetimit administrativ është zbulimi dhe vërtetimi i plotë i rrethanave që ndihmojnë vendimmarrjen në çështjen objekt shqyrtimi. Kjo është arsyeja pse Kodi Zgjedhor kufizon diskrecionin e trupës së KAS-it në marrjen dhe shqyrtimin e provave, kur përcakton se KAS-i “mund të refuzojë kërkesën e ankuesit apo të palës së interesuar për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 dhe pikës 2 të këtij neni, vetëm nëse vlerëson se prova nuk shërben për të vërtetuar faktet e pretenduara” dhe se ky refuzim duhet të jepet i arsyetuar në vendimin përfundimtar (pika 4 e nenit 136). Megjithatë, kuadri normativ i nenit 136 të Kodit Zgjedhor nuk mund të lexohet në kundërshtim me parimin e “barrës së provës”. Asnjë nga dispozitat e këtij neni, që formojnë detyrim për KAS-in për marrjen dhe shqyrtimin e provave, nuk mund të lexohet si mjet ligjor për të çliruar palën nga detyrimi për t’i siguruar vetë dhe paraprakisht provat që mbështesin pretendimet e ngritura në kërkesën ankimore.

10. Kodi i ka njohur dy anëtarëve të KAS-it privilegjin që të sigurojnë pa debat apo votim marrjen e provës (privilegji i pakicës), kur prova kërkohet nga pala dhe disponohet nga KQZ-ja. Privilegji i pakicës është mjet ligjor në duart e anëtarëve në pakicë, me qëllim që ata të anashkalojnë “diktatin e shumicës”. Por privilegji i pakicës nuk është ushtrim arbitrar apo voluntarist i të drejtës. Ai nuk mund të ushtrohet në zëvendësim të detyrimit të palës për të



siguruar vetë dhe paraprakisht provat që mbështesin pretendimet e saj, nuk mund të ushtrohet për të arritur qëllime të tjera nga ato të hetimit administrativ konkret, nuk mund të ushtrohet i palidhur me faktet e pretenduara. Privilegji i pakicës mund të ushtrohet vetëm në kushte ligjshmërie. Privilegji i pakicës nuk i nënshtrohet debatit apo votimit, përveçse kur ai ushtrohet pa administruar më parë kërkesën për marrjen e provës, të paraqitur nga ndonjera nga palët në proces, ose kur prova që pakica kërkon të marrë dhe administrojë nuk disponohet nga KQZ-ja.

11. Kërkesa e ankuesit për rinumërimin dhe rivlerësimin e fletëve të votimit të pavlefshme dhe e votave të kandidatëve për kryetar bashkie në zonën zgjedhore bashkia Rrogozhinë është kërkesë e paligjshme në gjykimin e shumicës së anëtarëve të KAS-it. Ankuesi kërkoi rinumërimin dhe rivlerësimin e të gjitha votave të hedhura, kur ligji lejon rinumërimin dhe rivlerësimin e vetëm votave të caktuara, vetëm të votave të identifikuara ose të kontestuara, sipas procedurave të neneve 116 dhe 118 të Kodit, për të cilat është kontestuar vlerësimi ose numri i tyre gjatë procesit të numërimit, si dhe të votave të tabelës së rezultatit të kundërshtuar, sipas pikës 2 të nenit 119 të Kodit. Shqyrtimi në seancë provoi se në këtë zonë zgjedhore nuk ka pasur kontestim të vlerësimit të votave dhe as kontestim të tabulimit të tyre gjatë procesit të numërimit të kryer nga GNV-të. Rinumërim dhe rivlerësim apriori, pa shkak ligjor, të votave nuk mund të ketë. Kjo është arsyeja që shumica rrëzoi kërkesën e ankuesit për kryerjen e rinumërimit dhe rivlerësimit tërësor të votave. Shumica gjykon, se për të njejtin shkak është i paligjshëm edhe ushtrimi i privilegjit të pakicës nga dy anëtarët e trupës që mbështetën kërkesën e paligjshme. Por, sa kohë që ushtrimi i privilegjit të pakicës nuk mund të hidhet në votim dhe nuk mund të pengohet, KASi është i detyruar t'a pranojë dhe t'i hapë rrugë marrjes së provës, me këtë konstatim për paligjshmëri veprimi.

12. Pretendimi i ankuesit, i parashtruar në tekstin e kërkesës ankimore nr.80, në kohën kur ankuesit nuk i ishin vënë në dispozicion pamjet video nga numërimi dhe vlerësimi i votave, ishte se “numri i votave të vlefshme të kandidatit Shkëlqim Hoxha, të cilat janë vlerësuar si të pavlefshme ose nuk janë përfshirë në numrin e votave të vlefshme të tij është relativisht i lartë”. Ankuesi pretendonte për “shkelje të ligjit zgjedhor në procesin e numërimit dhe të vlerësimit ku pothuaj për shumicën e qendrave të votimit të munëruara rezultati i dalë dhe i pasqyruar në tabelat e numërimit nuk pasqyrojnë rezultatin e vërtetë”. KAS-i i dha mundësinë dhe kohën ankuesit që t'i këqyrte pamjet video dhe të sillte provat e nevojshme për të mbështetur këtë pretendim. Ankuesi nuk mundi që ta provonte pretendimin e parashtruar në kërkesën ankimore. Ai paraqiti vetëm një tabelë për 7 QV, sipas së cilës “kandidatit Edison Memolla i hiqen 5 vota, ndërsa kandidatit Shkëlqim Hoxha i shtohen 3 vota”. Provat filmike të këtij pretendimi nuk u depozituan.

Pavarësisht nga kjo, ankuesi paraqiti kërkesën për rinumërim dhe rivlerësim të të gjitha votave të vlefshme e të pavlefshme, pa asnjë bazë ligjore. Kërkesa u mbështet nga dy anëtarët të KAS-it.

13. Rinumërimi dhe rivlerësimi i votave që u krye nga administrata e KQZ-së me pjesëmarrjen e vëzhguesve nga palët dhe nën mbikëqyrjen e KAS-it nuk zbuloi shkelje që mund të konsideroheshin cënim i rregullave në zbatimin e procedurës. Vetëm në një QV u konstatua tabulimi i dy votave më shumë për kandidatin e subjektit PS, gjë që kishte lidhje me pasqyrimin e parregullt në tabelë të dy votave të hedhura në kutinë e gabuar (pasqyrim i dyfishtë). KAS-i konstatoi nga këqyrja e votave të kontestuara në procesin e rinumërimit dhe rivlerësimit, se vlerësimi i votave ishte kryer nga grupet e numërimit sipas standartit dhe në përputhje me “udhëzuesin e punës për komisionet e zonave të administrimit zgjedhor dhe grupet e numërimit të votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, miratuar me vendimin nr.24, datë 05.05.2023 të Komisionit Rregullator. KAS-i e ndryshoi vlerësimin e bërë nga GNV-të vetëm për një numër të parëndësishëm votash, bazuar në leximin e ndryshëm dhe respektimin më adekuat të vullnetit të votuesve. Në përfundim të procedurës, diferenca e votave midis

kandidatit fitues dhe kandidatit të ankuesit zbriti nga 30 në 21 vota. Tabela me rezultatin e rinumërimit dhe rivlerësimit i bashkëlidhet këtij vendimi.

14. Ankuesi ka kontestuar ligjshmërinë e procesit të votimit në IEVP Rrogozhinë, në qendrën e votimit të të cilit kanë qenë të regjistruar për të votuar 119 zgjedhës (QV nr.2224/01), të gjithë persona që vuajnë dënimin me burgim në këtë institucion. Pretendimi i ankuesit është se përfshirja e këtyre personave në listën e zgjedhësve është bërë në kundërshtim me ligjin (Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë) dhe se akti që ka miratuar listë zgjedhësish për këtë QV është absolutisht i pavlefshëm. Një akt absolutisht i pavlefshëm nuk mund të sjellë pasoja. Prandaj rezultati i kësaj QV-je duhet të hiqet nga tabela përmbledhëse e rezultatit dhe shpallja e rezultatit për bashkinë Rrogozhinë të bëhet pa të, sqaruan përfaqësuesit e ankuesit në seancë.

15. Ankuesi ka kërkuar nga KAS-i që, në cilësinë e tij si organ publik, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të listës së zgjedhësve, për shkakun se miratimi i listës së zgjedhësve për IEVP Rrogozhinë vjen në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, konkretisht të Kodit Civil, i cili njuh vendqendrimin për personat që vuajnë dënimin dhe jo vendbanimin. Kjo mënyrë arsyetimi e çon KAS-in në mënyrë të paevitueshme në konkluzionin se kërkesës për pavlefshmëri akti, sa i takon listës së zgjedhësve, i mungon shkaku ligjor. Neni 108 i KPrA përkufizon akte absolutisht të pavlefshme jo aktet që vijnë “në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi”, sikurse referon ankuesi, por aktet që vijnë “në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:

i) kompetencën e organit publik;

ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose

iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit” (shkronja “a” e nenit 108).

Ankuesi ka “gjymtuar” dispozitën kur ka bërë referencën ligjore, ndoshta për mungesë të argumentave lidhur me kompetencën, procedurën dhe elementët e detyrueshëm të aktit. Kërkesa për pavlefshmërinë absolute të një akti, mbështetur në shkronjën “a” të nenit 108 të K.Pr.A shkakun ligjor mund ta gjejë vetëm tek mungesa e kompetencës, procedurës, formës ose elementëve të tjerë të detyrueshëm të aktit.

16. Kodi i Procedurave Administrative përcakton në pikën 2 të nenit 110 se “pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, të çdo të interesuari, nga organi publik që e ka nxjerrë atë, organi epror i tij apo organi që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative, si dhe nga gjykata kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit”. Kjo dispozitë kërkon që kërkesa për pavlefshmërinë absolute të aktit të depozitohet pranë organit që ka nxjerrë aktin.

17. Pika 1 e nenit 56 të Kodit Zgjedhor përcakton se “zyra e gjendjes civile harton listën e zgjedhësve për çdo zonë qendre votimi jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve, duke nxjerrë nga të dhënat elektronike të RKGjC-së të gjithë shtetasit që do të mbushin moshën 18 vjeç deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve dhe që kanë vendbanimin në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e saj. Lista miratohet nga kryetari i njësisë përkatëse të qeverisjes vendore”. Kjo dispozitë cakton organ përgjegjës për listën e zgjedhësve të IEVP Rrogozhinë Kryetarit e Bashkisë Rrogozhinë dhe jo Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kryetari i bashkisë është organ i vetqeverisjes vendore dhe gëzon pavarësi në ushtrimin e funksioneve. Sa i takon listës së zgjedhësve, drejtimi metodologjik dhe mbikëqyrja e procesit të hartimit dhe shpalljes së listës bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila ka në përgjegjësi regjistrin kombëtar të gjendjes civile. I takon ankuesit të çmojë nëse DPGJC është organ epror në kuptimin e pikës 2 të nenit 110 të KPrA, tek i cili ankuesi do të kishte mundësinë të depozitonte kërkesën për deklarimin absolutisht të pavlefshëm të vendimit të kryetarit të bashkisë Rrogozhinë, me të cilin është miratuar lista e zgjedhësve për QV-në e IEVP Rrogozhinë.

18. KAS-i është “organ kompetent për shqyrtimin e mjeteve ligjore administrative”, në kuptimin e nenit 110 të KPrA. KAS-i ka kompetencë shqyrtimin e kërkesave ankimore ndaj

vendimeve të KZAZ-ve dhe të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndërkohë që as KZAZ-të, as Komisioneri nuk kanë kompetencë miratimin e listave të zgjedhësve. KAS-i nuk është organ kompetent për “konstatimin e pavlefshmërisë absolute të listës së zgjedhësve të QV-së nr.2224/01”. Edhe nga këndvështrimi i kompetencës ligjore të KAS-it mund të konfirmohet, se kërkesa ankimore nr. 80, e cila ka objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionerit nr. 531, datë 18.05.2023 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për kryetar bashkia Rrogozhinë” futet në fushën e kompetencës së KAS-it, sepse ai është organ kompetent për të shqyrtuar kërkesat ankimore kundër vendimit të KZAZ-së ose të Komisionerit për shpalljen e rezultatit për zgjedhjet e organeve të njësisve të qeverisjes vendore të juridiksionit të tyre (pikat 2 dhe 3 të nenit 124 të Kodit Zgjedhor). Por ankimi ndaj këtyre vendimeve bëhet ose për ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe për pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi.

19. Ankuesi ka ngritur pretendimin se në QV-në nr.2224/01 të IEVP Rrogozhinë kanë votuar persona që nuk mund të gëzonin ligjërisht të drejtën për të qenë zgjedhës. E drejta e tyre buron nga një dispozitë ligjore (neni 18 i ligjit nr.10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”), e cila vjen në kundërshtim me një dispozitë ligjore me fuqi më të lartë (neni 14 i Kodit Civil). Kodi Civil u njeh personave të burgosur vendqëndrimin në vendin ku vuajnë dënimin dhe jo vendbanimin. Ligji i zbatueshëm për regjistrimin ose jo të tyre në gjendjen civile duhet të ishte Kodi Civil dhe jo ligji për gjendjen civile, sepse lex superior derogat leges inferiori. Ky pretendim i ankuesit i ngritur në kuadër të kërimit për pavlefshmërinë e aktit, duhet të merret në shqyrtim nga KAS-i, sepse ai mund të formojë shkak ligjor për pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Pika 2 e nenit 143 të Kodit Zgjedhor kërkon nga KAS-i që të marrë vendim, sipas njërës nga rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, pavarësisht nga ajo çfarë ankuesi ka kërkuar në ankimin e tij. (shkronja “ç” e pikës 1 - “në përfundim të shqyrtimit të ankimit KQZ-ja vendos sipas rastit...shpalljen e zgjedhjeve të pavlefshme në një ose disa qendra votimi të zonës zgjedhore ose në të gjithë njësinë zgjedhore”).

20. Ankuesi ka parë një kundërvënie midis nenit 14 të Kodit Civil dhe nenit 18 të ligjit për gjendjen civile, të cilën KAS-i nuk e sheh. Kodi Civil ka bërë dallimin midis konceptit të “banimit” dhe atij të “vendqëndrimit”. Këtë dallim Kodi Civil e sheh tek kohëqëndrimi “zakonisht ose të shumtën e kohës” në një vend. Ky është kriteri dhe vetëm kaq përcakton Kodi Civil. Për të shpjeguar “banimin” Kodi ka marrë për ilustrim termin “punë e përhershme”, “shërbim i përhershëm”, “pasuri”, “interesa”. Kjo nuk do të thotë se personi banon domosdoshmërisht vetëm atje ku ka punën apo pasurinë, aty ku shërben apo ku e lidhin interesat. Për të ilustruar “vendqëndrimin”, Kodi ka marrë termin “punë e caktuar” “detyrë e caktuar”, “shkollë e caktuar”, “kurs i caktuar”, “mjekim”, “vuajtje e dënimit penal”. Kjo nuk do të thotë se personi atje ku mjekohet, ku bën shkollë apo kurse, apo vuan dënimin është domosdoshmërisht me vendqëndrim. Shembujt ilustrues nuk mund të marrin vlerën e thelbit të dispozitës. Thelbi i dispozitës është se banimi është vendi ku personi qëndron “zakonisht ose të shumtën e kohës” dhe vendqëndrimi është vendi ku personi qëndron jo zakonisht dhe jo të shumtën e kohës. Terminologjinë e përgjithshme dhe të pa specifikuar të Kodit Civil, ligji për gjendjen civile e ka përkthyer në terminologji specifike dhe të detajuar. Neni 18 i tij ka vendosur si kriter dallues midis vendbanimit dhe vendqëndrimit qëndrimin për më shumë se 3 muaj në një vend të caktuar. Nëse personi jeton më shumë se tre muaj në një vend, atëherë, për efekt të ligjit do konsiderohet se ai aty jeton “zakonisht ose të shumtën e kohës”. Midis Kodit Civil dhe ligjit për gjendjen civile nuk ka kundërvënie.

21. KAS-i, ndryshe nga ankuesi, nuk sheh kundërvënie as midis vendimit nr.40, datë 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese dhe nenit 18 të ligjit për gjendjen civile. Analiza e vendimit të Gjykatës Kushtetuese mund të bëhet, duke e vendosur atë në kontekstin historik. Gjykata Kushtetuese atëkohë ishte vënë në lëvizje për shkakun se ligji zgjedhor i kohës (ligji nr.9341, datë 01.10.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9087, datë 19.06.2003 “Kodi



Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë””) i kishte hequr të drejtën për të votuar në zgjedhjet vendore një pjese të të burgosurve, duke ia njohur këtë të drejtë vetëm të burgosurve me vendbanim në njësinë administrative ku ndodhet institucioni i vuajtjes së dënimit. Pretendimi i Avokatit të Popullit ishte se “të burgosurit që kanë vendbanim të ndryshëm nga ai i vuajtjes së dënimit vendosen në pamundësi për të ushtruar të drejtën e votës, duke cënuar kështu një të drejtë të parashikuar nga neni 45/3 i Kushtetutës”.

22. Pra, objekti i vendimit gjyqësor në këtë çështje nuk ka qenë diskutimi, nëse të burgosurit duhet apo jo ta gëzojnë të drejtën aktive të zgjedhjes, por diskutimi nëse vendbanimi është kriter i ligjshëm për kufizimin e kësaj të drejte në zgjedhjet vendore. Gjykata Kushtetuese e ka quajtur kriter të ligjshëm. Kodi Zgjedhor në fuqi kriterin e vendbanimit e ka caktuar kriter universal, të gjithë shtetasit me të drejtë vote votojnë aty ku kanë vendbanimin, pavarësisht nga lloji i zgjedhjeve. Të burgosurit me vendbanim në institucionin e vuajtjes së dënimit votojnë në QV-në e vendbanimit të tyre, kurse të burgosurit që nuk kanë vendbanimin në institucionin ku vuajnë dënimin nuk mund të ushtrojnë të drejtën e tyre në këtë QV. Kodi Zgjedhor është në përputhje të plotë me vendimin nr.40, datë 16.11.2007, kurse ligji për gjendjen civile nuk krijon dot konflikt, sepse ai thjesht saktëson konceptin e vendbanimit, por nuk kufizon të drejtën për të votuar. Në këto kushte, KAS-i konkludon se analiza ligjore e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, dispozitave të Kodit Civil dhe dispozitave të ligjit për gjendjen civile nuk krijon shkak për të kërkuar pavlefshmëri të zgjedhjeve në këtë QV, sepse zbatimi i sejcilës prej dispozitave që kanë lidhje me vendbanimin, regjistrimi i të burgosurve në gjendjen civile të bashkisë ku ndodhet institucioni dhe, për pasojë, përfshirja e tyre në listën e zgjedhësve nuk formon antikushtetueshmëri dhe nuk përbën shkelje.

23. Aktet nënligjore që u sollën nga përfaqësuesit e ankuesit si referencë në seancë, VKM nr.1243, datë 11.12.2009 dhe urdhëri nr.76, datë 01.02.2023, me synimin për të provuar se gjendja civile në procedurat e veta zyrtare “njeh dhe zbaton për të dënuarit “vendqëndrimin” dhe jo “vendbanimin”, gjithashtu rezultojnë për KAS-in se janë në harmoni të plotë me nenin 18 të ligjit për gjendjen civile. VKM kërkon në pikën 4 të saj se “për shtetasit ... që kryejnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit apo qëndrojnë në institucionet e paraburgimit në pritje të vendimit gjyqësor ... dhe, kur qëndrimi në këto institucione zgjat më shumë se tre muaj, institucioni përgjegjës duhet të paraqesë, brenda 48 orëve nga data e regjistrimit të tyre në institucion, pranë zyrës së gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin përkatës, listën emërore të tyre”. Regjistrimi i tyre në nën rubrikën “me vendqëndrim të përkohshëm” të rubrikës “vendbanimi” nuk është argument për të mbajtur në këmbë kundërvënien dhe për të “provuar” tezën se “vetë administrata po injoron zbatimin e ligjit për gjendjen civile dhe po zbaton Kodin Civil, për shkak të kësaj kundërvënie”!!!.

24. Ankuesi ngriti pretendimin se zgjedhjet ku votojnë të burgosurit, sidomos ato ku vota e të burgosurve përcakton fituesin nuk janë zgjedhje të ndershme. “Ka një pyetje qëndrore, të cilës duhet t’i japim përgjigje: A është e drejtë, e ndershme dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare që kryetari i bashkisë të përcaktohet vetëm nga vota e të burgosurve?”, shkruan ankuesi në kërkesën ankimore. Në mbështetje të këtij pozicionimi, ankuesi referon tek debate apo studime nga Mbretëria e Bashkuar, por ato nuk mund të ngrihen në nivelin e standartit ndërkombëtar që evokon vetë ankuesi në pyetjen e vet retorike.

25. KAS-i nuk mund të operojë me kategori diskutimi filozofik në trajtimin e ankesës. Votimi i të burgosurve është një e drejtë kushtetuese e afirmuar nga ligji, praktika zgjedhore dhe jurisprudenca shqiptare. Në këtë kuptim, votimi i të burgosurve është standart shqiptar, të cilin KAS-i nuk ka pushtet ligjor që t’a vërë në diskutim. Faktet e çështjes provojnë se kandidati fitues nuk është zgjedhur “me votat e të burgosurve”, por me votat e shumicës së zgjedhësve që kanë marrë pjesë në votim, është zgjedhur me shumicë absolute votash. E drejta e të burgosurve për të votuar mbështetet nga Kushtetuta dhe ligji zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. Kufizimet në të drejtën për të votuar të kategorive të caktuara të të burgosurve,



janë kufizime ligjore, të bazuara në Kushtetutën e vendit dhe që janë zbatuar me korrektesë në rastin e QV nr.2224/01 të I.E.V.P Rrogozhinë. Sipas konfirmimit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr.6496/1 prot., datë 26.05.2023, lista prej 318 të burgosurish me të drejtë vote është pastruar nga subjektet që i nënshtrohen veprimit të ligjit nr.138/2015, duke u reduktuar në numrin 118 persona të regjistruar në listën e zgjedhësve.

26. Në QV nr.2224/01 të I.E.V.P Rrogozhinë kanë votuar 99 të burgosur, sipas informacionit të servitur në shkresën e mësipërme të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Shkresa e këtij institucioni informon se 24 persona janë transferuar në I.E.V.P Rrogozhinë në periudhën nga data 01.01.2023 deri në datën 14.05.2023. Nga këta persona, 21 janë përfshirë në listën e zgjedhësve, kurse 3 kanë votuar me vendim gjykatë.

27. Neni 56 i Kodit Zgjedhor parashikon se lista e zgjedhësve nuk ndryshon për asnjë shkak dhe asnjë rrethanë, pas kalimit të afatit “40 ditë para datës së zgjedhjeve”. Ky afat përkon me datën 4 prill 2023. Po kështu, pika 2 e nenit 57 të Kodit Zgjedhor përcakton se “në rast se zgjedhësi ndryshon vendbanimin pas shpalljes së listës së zgjedhësve, lista nuk ndryshon dhe zgjedhësi voton në qendrën e votimit ku ka emrin në listën e miratuar. Në rast se zgjedhësi paraqet kërkesë në gjykatë në kushtet e kësaj pike, kërkesa rrëzohet”. Këto dy dispozita vendosin kufij të prerë ligjorë për regjistrimin në listën e zgjedhësve të të dënuarve të transferuar rishtazi ose për pajisjen me vendim gjykatë të tyre. Shkresa nr.6496/1 prot., datë 26.05.2023 e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nuk jep informacion për datën e saktë të transferimit të 24 të burgosurve të sipërcituar. Ankuesi nuk shfaq interes në hetimin e kësaj të dhëne dhe nuk bëri përpjekje për të siguruar informacionin e duhur për secilin nga këta të dënuar, duke i hequr kështu çdo mundësi vetes për të verifikuar nëse ka pasur paligjshmëri në rastin e përfshirjes në votim të këtyre 24 apo 21 të burgosurve dhe për të kërkuar, nëse do ishte rasti, pavlefshërinë e zgjedhjeve në këtë QV, ndoshta për shkak të faktit se përfaqësuesit ligjorë të ankuesit u treguan në seancë të vendosur për të mos kërkuar pavlefshërinë e zgjedhjeve.

28. Ankuesi pretendoi se QV nr.2224/01 e I.E.V.P Rrogozhinë është ngritur në kundërshtim me ligjin, sepse kompetenca për ngritjen e saj i takonte Komisionerit, i cili duhet të vepronte me propozimin e KZAZ-së. Në praktikën për ngritjen e kësaj QV-je mungon si propozimi ashtu dhe akti i Komisionerit. Neni 43 i Kodit Zgjedhor përcakton se “KZAZ-ja, në përputhje me këtë Kod dhe me udhëzimet e KQZ-së, i propozon KQZ-së krijimin e KQV-ve të posaçme në institucionet e posaçme”. Edhe ky argument është përdorur nga përfaqësuesit e ankuesit në funksion të kërkesës për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit. Si i tillë ai do mund të shqyrtohej nga KAS-i vetëm në procedurë ankimi, pasi të ishte paraqitur më parë dhe të ishte rrëzuar me vendim nga Komisioneri. Edhe në këtë rast, KAS-i sheh tek kjo fabul një argument në favor të pretendimit për shpalljen e pavlefshëm të zgjedhjeve në këtë QV, prandaj sheh arsye të ligjshme për të hetuar në këtë drejtim.

29. Sikurse u provua nga debati në seancë, ngritja e QV-ve për zgjedhjet e radhës nuk bëhet bazuar në nenin 43 të Kodit Zgjedhor, sepse ai i referohet kompetencës së posaçme për ngritjen e komisioneve të posaçme. Ngritja e QV-ve bëhet bazuar në nenin 62 të Kodit Zgjedhor, i cili kompetencën ia njeht kryetarit të bashkisë. Pika 5 e këtij neni përcakton se “Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore... cakton dhe shpall vendndodhjen e qendrës së votimit”, kurse pika 2 e tij sqaron se “Institucionet e posaçme përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi. Qendra e votimit në këto institucione ngrihet kur në to ndodhen mbi 15 zgjedhës”. Sipas pikës 4 “vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit... Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja”. Kushtet dhe kriteret që ky nen përcakton rezultojnë se janë respektuar dhe në këtë procedurë nuk ka shkak për të kërkuar pavlefshmëri për ngritjen e QV-së nr.2224/01 të IEVP Rrogozhinë. Në listën e zgjedhësve të IEVP Rrogozhinë kanë qenë të regjistruar 119 zgjedhës, gjë që plotëson kriterin numerik për ngritjen e QV-së, në këtë institucion janë kryer procedura

votimi rregullisht në të shkuarën dhe adresa e QV-së mbetet e pandryshuar. Ngritja e QV-së është bërë me akt të kryetarit të bashkisë.

30. Ankuesi parashtroi në seancë edhe një argument tjetër që, për nga natyra është argument në favor të një kërkimi për pavlefshmëri zgjedhjesh, argumentin se numërimi i QV nr.2224/01 është bërë i fundit, kur rregullat strikte të numërimit të QV-ve kërkojnë numërimin me rradhë sipas numrit në rend rritës në QV-ve. Argumenti nuk u shoqëruar me analizën ligjore të shkeljes dhe me të nuk u lidh ndonjë pretendim. Gjithësesi, KAS-i ka detyrë t'a marrë atë në shqyrtim dhe t'a analizojë. Prishja e rradhës së numërimit për këtë QV është fakt i provuar nga shqyrtimi i çështjes. Që kjo shkelje të bëhet argument për pavlefshmëri duhet që ajo të kategorizohet si "shkelje që ka cënuar rëndë procesin zgjedhor".

31. Në raste të tjera KAS-i është shprehur se "shkelje që cënojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur" (për më shumë shih vendimet nr.89, datë 20.05.2021, nr. 91, datë 27.05.2021, nr. 94, datë 31.05.2021, nr. 95, datë 31.05.2021 etj.) Midis shkeljes dhe pasojës që sjell ajo duhet të ketë gjithmonë një masë kritike, e cila formon kufirin ndarës midis shkeljes dhe parregullsisë, sporadike, të izoluar, të pjesshme, të përsëritur, të përhapur, të kryer pa dashje ose me qëllim dhe shkeljes që pengon/largon zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyron ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërson në masë votën e hedhur. Shkelja e rradhës së numërimit të kutisë së QV-së nr.2224/01, pasojë të vetme ka ndryshimin e rradhës, por për shkak të saj nuk është përjashtuar asnjë zgjedhës nga votimi, nuk ka votuar askush kundër vullnetit të vet dhe nuk është tjetërsuar asnjë votë. Nga ana tjetër, shkelja e rradhës së numërimit të kutisë nuk mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore (edhe ky është shkak pavlefshmërie), sepse ky fakt nuk ka asnjë ndikim në rezultat. Votat e hedhura në këtë QV kanë qenë ato që kanë qenë, përpara se kutitë të vendoseshin në rradhë për t'u numëruar.

32. Bazuar në këtë analizë ligjore dhe faktike, KAS-i mund të pranojë dhe reflektojë vetëm ndryshimet në tabelën përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për kandidatët për kryetar bashkie në këtë zonë, që kanë dalë nga procesi i rinumërimit dhe rivlerësimit të votave të vlefshme dhe të pavlefshme dhe duhet të rrëzojë kërkesën për heqjen nga tabela përmbledhëse të rezultatit për QV-në 2224/01 të I.E.V.P Rrogozhinë, si pa bazë ligjore kërkimi.

*Pavlefshëria e zgjedhjeve në këtë QV rezulton e paprovuar".*

11. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, paditësat rezulton të ketë zënë më datë 09.06.2023, afatin e ankimit kundër Vendimit Nr.174 Dt.06.06.2023, me argumentin e mosszbardhjes së tij, deri në këtë datë, nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve.

12. Më datë 12.06.2023 rezulton të jetë publikuar i arsyetuar, Vendimit Nr.174 Dt.06.06.2023 i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

13. Më datë 14.06.2023, paditësat kanë plotësuar me shkaqe, ankimin e datës 09.06.2023, duke plotësuar edhe elementët e formës (nga ankim në padi etj), në zbatim të vendimit të ndërmjetëm datë 13.06.2023, të gjyqtarit relator, mbi plotësimin e të metave të padisë.

14. Kërkespatria objekt shqyrtimi, bazohet në argumentat se:

*"-Është më rëndësi të theksohet se në zgjedhjet e zhvilluara në 14 maj 2023 për kryetar në Bashkinë Rrogozhinë diferenca midis kandidatit të koalicionit "Bashkë Fitojmë" dhe kandidatit të subjektit Partia Socialiste, ishte në favor të kandidatit Shkëlqim Hoxha me 57 vota*

deri në momentin kur u hap kutia e fundit, ajo e qendrës së votimit nr.2224/1, I.E.P.V Rrogozhinë që rezultoi edhe kutia e votimit që i dha fitoren dhe kandidatit të PS-së, me një diferencë prej 21 votash.

Në mbështetje të nenit 145, 152 dhe vijues të Kodit Zgjedhor paraqitet kjo padi para Kolegjit Zgjedhor.

-KAS shprehet në vendimin e sipërcituar se: “20. Ankuesi ka parë një kundërvënie midis nenit 14 të Kodit Civil dhe nenit 18 të ligjit për gjendjen civile, të cilën KAS-i nuk e sheh. Kodi Civil ka bërë dallimin midis konceptit të “banimit” dhe atij të “vendqëndrimit”. Këtë dallim Kodi Civil e sheh tek kohëqendrimi “zakonisht ose të shumtën e kohës” në një vend. Ky është kriteri dhe vetem kaq përcakton Kodi Civil. Për të shpjeguar “banimin” Kodi ka marrë për ilustrim termin “punë e përhershme”, “shërbim i përhershëm”, “pasuri”, “interesa”. Kjo nuk do të thotë se personi banon domosdoshmerisht vetëm atje ku ka punën apo pasurine, aty ku shërben apo ku e lidhin interesat. Për të ilustruar “vendqëndrimin”, Kodi ka marrë termin “punë e caktuar” “detyrë e caktuar”, “shkollë e caktuar”, “kurs i caktuar”, “mjekim”, “vuajtje e dënimit penal”. Kjo nuk do të thotë se personi atje ku mjekohet, ku bën shkollë apo kurse, apo vuan dënimin është domosdoshmerisht me vendqëndrim. Shembujt ilustrues nuk mund të marrin vlerën e thelbit të dispozitës. Thelbi i dispozitës është se banimi është vendi ku personi qëndron “zakonisht ose të shumtën e kohës” dhe vendqëndrimi është vendi ku personi qëndron jo zakonisht dhe jo të shumtën e kohës. Terminologjinë e përgjithshme dhe të pa specifikuar të Kodit Civil, ligji për gjendjen civile e ka përkthyer në terminologji specifike dhe të detajuar. Neni 18 i tij ka vendosur si kriter dallues midis vendbanimit dhe vendqëndrimit qëndrimin për më shumë se 3 muaj në një vend të caktuar. Nëse personi jeton më shumë se tre muaj në një vend, atëherë, për efekt të ligjit do konsiderohet se ai aty jeton “zakonisht ose të shumtën e kohës”. Midis Kodit Civil dhe ligjit për gjendjen civile nuk ka kundërvënie.”

Në referim të përmbajtjes në Kodin Zgjedhor të nenit 165, dhe nenit 12 të Kodit Civil si dhe nenit 18 të ligjit nr.10 129, date 11.5.2009 “Për gjendjen civile” rezulton se Instituti i vendbanimit dhe ai i vendqëndrimit janë institute të së drejtës civile të parashikuar në Kodin Civil. Parashkimi që bën Kodin Civil shqiptar për to është i njëjtë me parashikimet e Kodit Civil Italian. Në asnjë rresht të Kodit Civil nuk është bërë delegimi për t’u përcaktuar me ligj se kur një vendqëndrim shndërrohet në vendbanim, ashtu siç e ka realizuar neni 18 i ligjit “Për gjendjen Civile”. Neni 12 dhe neni 14 i Kodit Civil nuk janë me formulime si dispozitë deleguese; kur një gjë e tillë është dashur Kodi Civil e ka bërë në mënyrë të shprehur psh me formulimin e nëneve: Neni 38, 152 apo 163 të tij. Në lidhje me konceptin e vendbanimit dhe vendqëndrimit ato janë institute të pandryshuara që nga miratimi i dispozitave përkatëse në Kodit Civil. Vendqëndrime janë vendet ku shtetasi ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për t’u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal, dhe për raste të tjera të kësaj natyre (neni 14 i Kodit Civil). Sipas nenit 38 të Kushtetutës kushdo ka të drejtë të zgjedhë vendbanimin. Është e drejtë e njeriut dhe e drejtë kushtetuese e individit të zgjedhë vendbanimin, por jo vendqëndrimin sepse ky i fundit mund të ndryshojë psh në varësi të rrethanave shëndetësore apo për shkak të një dënimi me burgim. Vendqëndrimi përcaktohet jo si një çështje zgjedhjeje e lirë e individit psh në rast se dënohet me vendim me burgim apo paraburgim, nuk është më çështje zgjedhjeje, ndaj përbën vendqëndrim. Përsa kohë nuk është çështje e zgjedhjes së lirë të individit (kur është në burg ose paraburgim), ai {vendbanimi} nuk mund të imponohet dhe të kufizohet me një ligj me shumicë të thjeshtë siç është ligji në fuqi “Për gjendjen civile”, pavarësisht faktit që ai është miratuar më vonë në kohë.

Qartazi ka një mospërputhje mes formulimeve të bëra në Kodin Zgjedhor dhe Kodin Civil me nenin 18 të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”. Përparësinë e zbatimit të drejtpërdrejtë të ligjit në një hierarki më të lartë normative e përcakton qartë jurisprudenca kushtetuese.



Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.2, date 03.02.2010 përcakton se: "Gjyqtarët duhet të kenë parasysh dhe raportet ndërmjet ligjeve që miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (ligje të përforcuara), sipas nenit 81/2 të Kushtetutës dhe ligjeve që miratohen sipas rregullit të përgjithshëm të parashikuar nga neni 78 i Kushtetutës. Kushtetuta i jep ligjeve të përforcuara fuqi të veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve, ato renditen para ligjeve të zakonshme të Kuvendit (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 03.05.2007). Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër (lex superior derogat inferiori). Parimet, se norma specifike ka përparësi nga norma e përgjithshme (lex specialis derogat generali) dhe se norma që ka hyrë në fuqi më vonë ka përparësi nga norma e mëparshme, nuk veprojnë në raste të tilla."

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 03.05.2007 përcakton se: "Referimi i drejtpërdrejtë nga Kushtetuta i mënyrës së miratimit të ligjeve organike të institucioneve të sipërpërmendura u jep atyre fuqi të veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve, ata renditen pas Kushtetutës dhe para ligjeve të zakonshme të Kuvendit. Mbështetur në këto konsiderime Gjykata Kushtetuese rithekson se ligjet e zakonshme duhet të nxirren jo vetëm në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës, por duhet treguar kujdes i veçantë që ata të mos prekin rregullimet që përfshihen natyrshëm në sferën ekskluzive të ligjeve organike, përndryshe ato do të binin në kundërshtim me nenet 6 dhe 81, pika 2, shkronja "a" të Kushtetutës.

Nga ana tjetër, kjo do të thotë se edhe ndryshimet që mund t'u bëhen këtyre ligjeve ose dispozitave të veçanta të tyre nuk mund të arrihen nëpërmjet një ligji të thjeshtë, por nëpërmjet një ligji që do të kërkonte sërish të paktën tri të pestat e deputetëve. Kjo gjë arsyetohet me faktin e thjeshtë se rendi juridik nuk përbëhet nga norma juridike të barasvlershme apo me të njëjtën fuqi juridike, përkundrazi ai është një sistem i shkallëzuar, ku normat e së drejtës renditen në bazë të fuqisë juridike që kanë. Uniteti i këtij sistemi qëndron në varësinë që ekziston ndërmjet normës "krijuese" dhe normës së "krijuar".

Kodi Civil dhe Kodi Zgjedhor janë ligje organike që miratohen me jo më pak se tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit sipas neneve 6 dhe 81, pika 2, shkronja "a" të Kushtetutës, ndërsa ligji "Për gjendjen civile" miratohet me shumicë të thjeshtë të votave nga Kuvendi. Jurisprudenca i ka dhënë zgjedhje konfliktit që krijohet mes ligjeve duke pranuar përparësinë që kanë ligjet që miratohen më shumicë të cilësuar kundrejt ligjeve që miratohen më shumicë të thjeshtë. Në çështjen konkrete ligji i vetëm i zbatueshëm është Kodi Civil dhe Kodi Zgjedhor dhe jo ligji "Për gjendjen civile" neni 18 i tij.

-KAS në vendimin e sipërcituar është shprehur se: "21. KAS-i, ndryshe nga ankuesi, nuk sheh kundërvënje as midis vendimit nr.40, date 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese dhe nenit 18 të ligjit për gjendjen civile. Analiza e vendimit të Gjykatës Kushtetuese mund të bëhet, duke e vendosur atë në kontekstin historik. ...22. Pra, objekti i vendimit gjyqësor në këtë çështje nuk ka qenë diskutimi, nëse të burgosurit duhet apo jo ta gëzojnë të drejtën aktive të zgjedhjes, por diskutimi nëse vendbanimi është kriter i ligjshëm për kufizimin e kësaj të drejte në zgjedhjet vendore. Gjykata Kushtetuese e ka quajtur kriter të ligjshëm. Kodi Zgjedhor në fuqi kriterin e vendbanimit e ka caktuar kriter universal, të gjithë shtetasit me të drejtë vote votojnë aty ku kanë vendbanimin, pavarësisht nga lloji i zgjedhjeve. Të burgosurit me vendbanim në institucionin e vuajtjes së dënimit votojnë në QV-në e vendbanimit të tyre, kurse të burgosurit që nuk kanë vendbanimin në institucionin ku vuajne dënimin nuk mund të ushtrojnë të drejtën e tyre në këtë QV. Kodi Zgjedhor është në përputhje të plotë me vendimin nr. 40, datë 16.11.2007, kurse ligji 'Për gjendjen civile' nuk krijon dot konflikt, sepse ai thjesht saktëson konceptin e vendbanimit, por nuk kufizon të drejtën për të votuar. Në këto kushte, KAS-i



konkludon se analiza ligjore e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, dispozitave të Kodit Civil dhe dispozitave të ligjit 'Për gjendjen civile' nuk krijon shkak për të kërkuar pavlefshmeri të zgjedhjeve në këtë QV, sepse zbatimi i secilës prej dispozitave që kanë lidhje me vendbanimin, regjistrimi i të burgosurve në gjendjen civile të bashkisë ku ndodhet institucioni dhe, për pasojë, përfshirja e tyre në listën e zgjedhësve nuk formon antikushtetueshmëri dhe nuk përbën shkelje".

Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.40, datë 16.11.2007 në të cilin është arsyetuar ndër të tjera se: "Megjithatë e drejta e votës nuk është absolute, ajo mund të bëhet objekt i kufizimeve.... Një nga dallimet midis këtyre dy dispozitave është se për zgjedhjet vendore ligjvënasi e ka lidhur ushtrimin e të drejtës së votës me vendbanimin, ndërsa për zgjedhjet e përgjithshme jo. Arsyeja e këtij dallimi duhet kërkuar tek fakti se në zgjedhjet e përgjithshme votohet për anëtarët e organit ligjvënës, të cilët i përkasin të gjithë popullit. Një nga parimet kryesore të përfaqësimit popullor është edhe mungesa e mandatit detyrues të deputetit, pra deputed përfaqëson jo zonën zgjedhore ku ai votohet por të gjithë zgjedhësit. Ndryshe ndodh në rastin e zgjedhjeve vendore. Këtu synohet një lidhje më e ngushtë midis zgjedhësit dhe të zgjedhurit për vetë natyrën e organizimit dhe kompetencave të pushtetit lokal. Është pushteti vendor që kujdeset për zgjidhjen e problemeve aktuale të qytetarëve që lidhen me çështje të tilla si punësimi, kujdesi shëndetësor, arsimit parashkollor, pastrimi dhe gjelbërimi i mjediseve të njësisë vendore, etj. Për këtë arsye, votimi në zgjedhjet vendore trajtohet si pjesë e struktures së demokracisë nga poshtë lartë duke u mundësuar zgjedhësve pjesëmarrjen në qeverisje edhe në forumet më të vogla, përveç parlamentit kombëtar. Në këtë këndvështrim, pranohet se pushteti lokal është më afër qytetarëve dhe këta të fundit janë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve në drejtimin e njësisë vendore ku ata kanë vendbanimin.

Në këtë kuptim, vendbanimi është pika qendrore e marrëdhënieve jetësore të një njeriu. Është kërkesë ligjore që një person të ketë një vendbanim kryesor, brenda një juridiksioni të caktuar, me qëllim që të votojë, të punësohet ose të presë përfitime të tjera brenda këtij juridiksioni. Kushti për të pasur vendbanimin në zonën zgjedhore është një nga kufizimet e të drejtës së votës, e cila bashkë me kriterin e shtetësisë synojnë të vendosin një lidhje direkte, qoftë edhe minimale, midis votuesit dhe rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Në këtë mënyrë sigurohet legjitimiteti i votës në një zonë të caktuar.

Në këtë këndvështrim, duket me vend që neni 63/3 i Kodit Zgjedhor e lidh ushtrimin e të drejtës së votës për të burgosurit me konceptin e vendbanimit dhe jo me vendin e vuajtjes së dënimit ose vendqëndrimin.

Vlera e vendimit të sipërcituar të Gjykatës Kushtetuese nuk përbën memorie historike, as edhe relike që është varrosur e nuk krijon efektet. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese sqaron konceptin e ushtrimit të së drejtës së votës në zgjedhjet lokale sipas kriterit themeltar të vendbanimit në kuptimin e Kodit Civil, dhe kjo është shumë thelbësore. Për të përdorur terminologjinë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, zgjedhjet vendore janë një lidhje më e ngushtë midis zgjedhësit dhe të zgjedhurit për vetë natyrën e organizimit dhe kompetencave të pushtetit vendor. Është pushteti vendor që kujdeset për zgjidhjen e problemeve aktuale të qytetarëve që lidhen me çështje të tilla si punësimi, kujdesi shëndetësor, arsimit parashkollor, pastrimi dhe gjelbërimi i mjediseve të njësisë vendore, etj. Kushti për të pasur vendbanimin - sipas Kodit Civil dhe Kodit Zgjedhor - në zonën zgjedhore përkatëse është një nga kufizimet e të drejtës së votës, e cila bashkë me kriterin e shtetësisë synojnë të vendosin një lidhje direkte, qoftë edhe minimale, midis votuesit dhe rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Vetëm në këtë mënyrë sigurohet legjitimiteti i votes në një zonë të caktuar.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese përbën gur themeli sepse konsideron themelin e votës për përfaqësuesin e popullit në pushtetin që qëndron më afër tij, pikërisht për shkak të lidhjeve të qëndrueshme zgjedhës me vendbanim - i zgjedhur kryetar bashkie. Nuk mund të bëhet bypass të këtij parimi me artifica në I.E.P.V të tipit 3 mujor. Ligji "Për gjendjen civile" pikërisht

deformon konceptin e vendbanimit sepse vendimi i Gjykatës Kushtetuese në zgjedhjet vendore e lidh vendbanimin dhe vendqëndrimin sipas koncepteve të Kodit Civil. Nuk ka shndërrim nga vendqëndrim në vendbanim sipas Kodit Civil po qe se individi qëndron të paktën 3 muaj në vendqëndrim.

-KAS në vendimin e sipërcituar shprehet se: “23. Aktet nënligjore që u sollën nga përfaqësuesit e ankuesit si referencë në seancë, VKM nr.1243, datë 11.12.2009 dhe urdhëri nr.76, datë 01.02.2023, me synimin për të provuar se gjendja civile në procedurat e veta zyrtare “njeh dhe zbaton për të dënuarit “vendqëndrimin ” dhe jo “vendbanimin”, gjithashtu rezultojnë për KAS-in se janë në harmoni të plotë me nenin 18 të ligjit për gjendjen civile. VKM kërkon në pikën 4 të saj se “për shtetasit ... që kryejnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit apo qëndrojnë në institucionet e paraburgimit në pritje të vendimit gjyqësor ... dhe, kur qëndrimi në këto institucione zgjat më shumë se tre muaj, institucioni përgjegjës duhet të paraqesë, brenda 48 orëve nga data e regjistrimit të tyre në institucion, pranë zyrës së gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin përkatës, listën emërore të tyre”. Regjistrimi i tyre në nënrubrikën “me vendqëndrim të përkohshëm” të rubrikës “vendbanimi” nuk është argument për të mbajtur në këmbë kundërvënien dhe për të “provuar” tezën se “vetë administrata po injoron zbatimin e ligjit për gjendjen civile dhe po zbaton Kodin Civil, për shkak të kësaj kundërvënie ”!!!.....29. Sikurse u provua nga debati në seancë, ngritja e QV-ve për zgjedhjet e radhës nuk bëhet bazuar në nenin 43 të Kodit Zgjedhor, sepse ai i referohet kompetencës së posaçme për ngritjen e komisioneve të posaçme. Ngritja e QV-ve bëhet bazuar në nenin 62 të Kodit Zgjedhor, i cili kompetencën ia njeh kryetarit të bashkisë. Pika 5 e këtij neni përcakton se “Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore... cakton dhe shpall vendndodhjen e qendrës së votimit”, kurse pika 2 e tij sqaron se “Institucionet e posaçme përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi. Qendra e votimit në këto institucione ngrihet kur në to ndodhen mbi 15 zgjedhës”. Sipas pikës 4 “vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit... Vendndodhja e qendres së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja. Kushtet dhe kriteret që ky nen përcakton rezultojnë se janë respektuar dhe në këtë procedurë nuk ka shkak për të kërkuar pavlefshmëri për ngritjen e QV-së nr. 2224/01 të I.E.V.P Rrogoshinë. Në listën e zgjedhësve të I.E.V.P Rrogoshinë kanë qenë të regjistruar 119 zgjedhës, gjë që plotëson kriterin numerik për ngritjen e QV-së, në këtë institucion janë kryer procedura votimi rregullisht në të shkuarën dhe adresa e QV-së mbetet e pandryshuar. Ngritja e QV-së është bërë me akt të kryetarit të bashkisë.”

Neni 2, pika 2 e Kodit Zgjedhor përkufizon “institucionet e posaçme” si “burgjet, vendet e paraburgimit, si dhe spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se tri ditë”. Neni 43 i këtij Kodi parashikon se “KZAZ-ja, në përputhje me këtë Kod dhe me udhëzimet e KQZ-së, i propozon KQZ-së krijimin e KQV-ve të posaçme në institucionet e posaçme. Këto komisione kanë të njëjtën përbërje dhe të njëjtat përgjegjësi si edhe KQV-ja”. Neni 62 pika 2 e parashikon se “Institucionet e posaçme përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi. Qendra e votimit në këto institucione ngrihet kur në to ndodhen mbi 15 zgjedhës”.

Gjatë shqyrtimit administrativ në KAS rezultoi se Bashkia Rrogoshinë, me shkresën Nr.532/1 Prot., datë 07.03.2023 me lëndë “Propozim për krijimin e Qendrës së Votimit” drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i ka propozuar këtij të fundit krijimin e qendrës së votimit të posaçme me nr.2224/01 në Njësinë Rrogoshinë duke cituar ndër të tjera në shkresë se: “Në bazë të shkresës së ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Institucioni i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Rrogoshinë me Nr. 702 Prot., datë 26.02.2023, administruar në institucionin tonë me nr. 532 Prot., datë 07.02.2023 për 109 votues që kryejnë dënimin në I.E.V.P Rrogoshinë dhe kanë të drejtë vote bashkëngjitur po ju dërgojmë kërkesën dhe listën e votuesve”.

Më tej I.E.V.P Rrogozhinë, me anë të shkresës me Nr.1491 Prot., datë 21.03.2023, me lëndë "Dërgim dokumentacioni" drejtuar Bashkisë Rrogozhinë, i dërgon listën me 118 të dënuar dhe të paraburgosur që ndodhen pranë kësaj I.E.V.P-je duke cituar se: "Në vijim të shkresave të mëparshme, në kuadër të përgatitjeve për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, po ju dërgojmë listën e të dënuarve që vuajnë dënimin në institucionin tonë aktualisht në funksion të përgatitjes së regjistrimit të zgjedhësve. Kjo për efekt të regjistrimit për zgjedhjet e datës 14 maj 2023 dhe për ndjekjen e procedurave të mëtejshme të regjistrimit të kësaj qendre votimi në institucionin tonë... Bashkëlidhur po ju dërgojmë për veprim listën për 318 të dënuarve siguri e zakonshme që janë aktualisht në institucionin tonë me të gjithë të dhënat e tyre të vendlindjeve dhe vendbanimeve si dhe për veprat penale përkatëse që akuzohen, dënimet e dhëna penale, koha e dënimit të mbetur etj, të cilat duhet të mbahen parasysh nga ana juaj në lidhje dhe me përjashtimet nga votimi i personave që mund të bëhen për shkak të veprës penale në bazë të ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse që do të jenë në fuqi. Nga ana jonë nga lista e plotë e të dënuarve që vuajnë dënimin në institucionin tonë janë hequr me përjashtimet e Ligjit Nr.138/2015 të dënuarit përkatës dhe kanë mbetur 118 të dënuar, të cilët mbeten për tu vlerësuar edhe nga ana juaj nëse do të përfshihen ose jo në zgjedhjet e datës 14 maj 2023 duke marrë parasysh faktin që janë zgjedhje për Kryetar Bashkie.

V. O. Për çdo të dhënë tjetër shtesë që ju duhet dhe ne e disponojmë, rakordim bashkëpunim ose për çdo ndryshim në listat (të dënuar që mund të lirohen dhe hyrjeve të reja) në vijim do të mbetemi në kontakt në vijueshmëri dhe me përparësi".

Kurse Bashkia Rrogozhinë me anë të shkresës me Nr.1214/1 Prot., datë 31.03.2023, me lëndë "Shkresë përcjellëse", i drejtohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me tekstin "Bashkëngjitur po ju dërgojmë shkresën me Nr.1491 prot., datë 21.03.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, I.E.V.P Rrogozhinë, administruar në institucionin tonë me Nr.1214 Prot., date 24.03.2023.

Lista e zgjedhësve në Kodin Zgjedhor ka një procedurë të mirëpërcaktuar me etapa dhe me afate konkrete. Në lidhje me kriteret për përfshirjen e zgjedhësve në listat zgjedhore, nëni 44 shkronjat "d" dhe "dh" të Kodit Zgjedhor që parashikon se: "Kriteret për përfshirjen e një personi në listën e zgjedhësve janë:... d) të ketë vendbanimin e regjistruar në territorin e një prej zonave të qendrave të votimit; dh) të regjistrohet zgjedhës në listën e vetëm një zonë qendre votimi".

Në lidhje me përbërësit zgjedhorë Kodi Zgjedhor në referim të përmbajtjes së nenit 45, 51 pika 4, 53 pikat 1 dhe 2, 54 pika 1 të tij ka rezultuar se nga shkresat e cituara më sipër vihet re se I.E.V.P Rrogozhinë ia ka dërguar Bashkisë Rrogozhinë listën me 118 të dënuar që vuajnë dënimin në atë I.E.V.P në datën 24 mars 2023, nga e cila rezulton që vetëm dy prej tyre ishin me vendbanim në Rrogozhinë. Duke qenë se për pjesën tjetër të listës (117 të dënuar) është ndryshuar vendbanimi pas datës 24 mars 2023 (që është data kur Bashkia Rrogozhinë është vënë në dijeni të personave që vuajnë dënimin në I.E.V.P Rrogozhinë) palët janë në kushtet e shkeljes flagrante të nenit 54, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

-Element tjetër i rëndësishëm është dhe mënyra e përcjelljes së listës së personave që vuajnë dënimin në I.E.V.P Rrogozhinë nga kjo e fundit. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 11.12.2009 "Për përcaktimin e dokumenteve, që duhet të paraqesin shtetasit, e të procedurave, që duhet të kryejnë zyrat e gjendjes civile, në bashki/njësi administrative dhe institucionet shtetërore, të posaçme, për ndryshimin e vendbanimit/adresës së shtetasve" i ndryshuar, në pikat 4, 5 dhe 6 të tij parashikon se:

"4. Për shtetasit, të cilët kryejnë shërbimin ushtarak apo detyra në Forcat e Armatosura e banojnë brenda territorit të njesisë së Forcave të Armatosura, që kryejnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit apo qëndrojnë në institucionet e paraburgimit në pritje të vendimit gjyqësor, që qëndrojnë pa ndërprerje në institucione shëndetësore, për kurim mjekësor afatgjatë dhe kur qëndrimi në këto institucione zgjat më shumë se tre muaj,



institutioni përgjegjës duhet të paraqesë, brenda 48 orëve nga data e regjistrimit të tyre në institucion, pranë zyrës së gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin përkatës, listën emërore të tyre.

5. Lista emërore e hartuar nga institucionet e parashikuara në pikën 4, të këtij vendimi, duhet të përmbajë emrin, mbiemrin dhe numrin personal. Kjo listë i dërgohet zyrës së gjendjes civile përkatëse nëpërmjet sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik.

6. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile për këtë kategori shtetasish kryen veprimet sipas rregullave të percaktuara nga ministri, që mbulon gjendjen civile”.

Nga sa më sipër rezulton e qartë se mënyra e përcjelljes së listës nga ana e I.E.V.P Rrogozhinë ka qenë në kundërshtim me parashikimet e VKM si në aspektin e afatit të paraqitjes së listës emërore, ashtu edhe të mënyrës së përcjelljes së saj. Nga hartimi i listës së QV nr. 2224/1 është shkelur neni 54, pika 1 e Kodit Zgjedhor nga ana e Bashkisë Rrogozhinë, por edhe pikat 4, 5 dhe 6 të VKM së sipërcituar.

-I.E.V.P Rrogozhinë dhe vetë Bashkia Rrogozhinë e kanë trajtuar procedurën e ndryshimit të vendbanimit të personave që vuajnë dënimin në këtë I.E.V.P dhe i kanë konsideruar këta shtetas vetëm si “lëndë e parë për votim” dhe jo për të zbatuar legjislacionin në fuqi sipas afateve që përcaktohen në të. Vendbanimi i këtyre personave, nëse do të ishte zbatuar në mënyrë strikte ligji nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile” i ndryshuar, do duhej të bëhej individualisht për secilin prej tyre 48 orë pas paraqitjes në këtë I.E.V.P dhe jo sikundër ka ndodhur en bloc dhe vetëm për efekte zgjedhore.

Madje dhe lista e të dënuarve nuk është dërguar e plotë pasi 200 persona nuk janë përfshirë për efekt të legjislacionit në fuqi të dekriminalizimit. Pra, paradoksisht I.E.V.P Rrogozhinë edhe pse ka 318 persona që vuajnë dënimin në ambientet e saj, i ka dërguar Bashkisë Rrogozhinë vetëm 118 persona për të ndryshuar vendbanimin.

-Gjatë shqyrtimit administrativ të kësaj kërkesë ankimore, KQZ dështoi të provojë se për zgjedhjet e datës 14 maj 2023 të jetë respektuar procedura e kërkuar nga neni 43 i Kodit Zgjedhor në lidhje me KQV-të e posaçme.

Edhe nëse biet dakort një moment se QV është krijuar sipas ligjit, lind pyetja po Komisionin e Qendrës së Votimit në I.E.P.V Rrogozhinë kush e krijoi. Sipas nenit 43 të Kodit Zgjedhor duhet që të krijohet Komisioni i Qendrës së Votimit në institucionin e posaçëm duhet të ketë propozim nga KZAZ-ja përkatëse dhe miratim nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Nuk ka asnjë provë nëpërmjet të cilave të provohej se krijimi i kësaj qendre votimi të jetë bërë nga KQZ me propozim të KZAZ nr.43 që mbulon Bashkinë Rrogozhinë. KAS qëllimisht as nuk e përmend dhe as nuk e analizon këtë shkelje flagrante. Rezulton se Zgjedhjet në I.E.P.V Rrogozhinë janë bërë nga një komision qendre votimi që nuk ka akt të krijimit të tij.

Mungesa e një vendimmarrje në zbatim të nenit 43 të Kodit Zgjedhor nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i ka pamundësuar palëve të drejtën e ankimit për krijimin/ngritjen e kësaj qendre votimi të posaçme dhe komisionit të tij. KAS në vendimin e tij shprehet se: “28. Ankuesi pretendoi se QV nr.2224/01 dhe I.E.V.P Rrogozhinë është ngritur në kundërshtim me ligjin, sepse kompetenca për ngritjen e saj i takonte Komisionerit, i cili duhet të vepronte me propozimin e KZAZ-së. Në praktikën për ngritjen e kësaj QV-je mungon si propozimi ashtu dhe akti i Komisionerit. Edhe ky argument është përdorur nga përfaqësuesit e ankuesit në funksion të kërkesës për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit. Si i tillë ai do mund të shqyrtohej nga KAS-i vetëm në procedurë ankimi, pasi të ishte paraqitur më parë dhe të ishte rrëzuar me vendim nga Komisioneri.

Për krijimin e Komisionit në Qendrën e Votimit I.E.P.V Rrogozhinë nuk ka akt administrativ të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për pasojë nuk mund të ankimohet një akt që nuk ekziston.

-Ndërkohë, e kundërta ka ndodhur në zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars 2022, ku rezulton se KZAZ nr.43, bashkia Rrogozhinë i është drejtuar me shkresë “Propozim për



krijimin e KQV-së së posaçme Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve, i cili me anë të vendimit nr.125, datë 04.03.2022 "Për krijimin e KQV-së së posaçme dhe sasinë e fletëve të votimit për qendrën e posaçme të votimit nr. 22241, në KZAZ nr. 43, Bashkia Rrogozhinë" ka vendosur:

1. Të autorizojë KZAZ-në nr.43, bashkia Rrogozhinë që me vendim, të krijojë dhe emërojë Komisionin e Qendrës së Posaçme të Votimit nr. 22241. 2. Të autorizojë KZAZ-në nr. 43, bashkia Rrogozhinë të marrë nga 20 (njetzet) fletë votimi nga QV nr. 2225, QV nr. 2226 dhe QVnr. 2226/1, dhe t'i dorëzojë në KQV-në nr. 22241. Në total do të merren 60 (gjashtëdhjetë) fletë votimi për të pajisur QV nr. 22241. 3. KZAZ nr. 43 të marrë masat që QV nr. 22241 të pajiset me fletët e votimit nga QV-të e cituara në pikën 2. 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve/

-Këtë procedurë e konfirmon edhe Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën e saj Nr.6496/1 Prot, datë 26.05.2023 me lëndë "Kthim përgjigje lidhur me listat zgjedhore në I.E.V.P Rrogozhinë dhe I.E.V.P Lushnjë drejtuar perfaqësuesit të subjektit zgjedhor koalicioni "Bashkë Fitojmë". Më konkretisht në këtë shkresë citohet se "Gjatë procesit zgjedhor, ka patur pretendim nga Bashkia Fushë-Krujë për të mos regjistruar zgjedhës nga burgju për arsye se janë zgjedhje vendore dhe për këtë kemi dërguar e-mail Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 27.03.2023, i cili po me datën 27.03.2023, ora 16:27, sqaron "Ndërsa neni 43 ngarkon KZAZ-në, t'i propozojë KQZ-së krijimin e KQV-ve (Komisionit të Qendrës së Votimit) të posaçme në institucionet e posaçme. Këto komisione kanë të njëjtën përbërje dhe të njëjtat përgjegjësi si dhe vete KQV-ja. Përsa më sipër Kodi Zgjedhor nuk ka asnjë parashikim për ndalimin e krijimit të qendrave të votimit për zgjedhjet vendore. Në këto kushte në rast se plotësohen kriteret ligjore për listën e zgjedhësve në zonën e qendrës së votimit I.E.V.P, ato qendra votimi ngrihen në përputhje me parashikimet e sipërcituara".

Shkresat e cituara më sipër të Bashkisë Rrogozhinë nuk mund të interpretohen si zëvendësim i procedurës së parashikuar nga neni 43 i Kodit Zgjedhor apo si pjesë e procedurës së parashikuar në pikat 4 dhe 5 të nenit 62 të Kodit Zgjedhor.1

-Është alogjike të pretendosh se mund të ndryshohet vendndodhja e një qendre votimi në një institucion të posaçëm kur ajo mund të jetë vetëm brenda vetë institucionit të posaçëm dhe datat e këtyre shkresave që janë të muajit mars 2023 nuk janë në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 5 të nenit 62 të Kodit Zgjedhor që referon te pika 4 e nenit 51 të po këtij Kodi duke parashikuar "Jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve ...". Duke qenë se Dekreti nr. 13864 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore" mban datën 24.10.2022, atëherë vendndodhja e qendrës së votimit nr. 2224/1 duhet të caktohet dhe shpallet brenda datës 24.11.2022 dhe jo në muajin mars të vitit 2023.

-Lista e zgjedhësve të qendrës së votimit nr.2224/1, më konkretisht sa i përket ekstraktit të përbërësve zgjedhorë, është ndryshuar në kundërshtim me nenin 54 të Kodit Zgjedhor, por edhe vetë qendra e votimit 2224/1 (KQV) është krijuar në kundërshtim me nenin 43 të Kodit Zgjedhor. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023 të rezultatit zgjedhor të qendrës së votimit nr.2224/1, I.E.V.P Rrogozhinë, është i vërtetë vetëm fakti se në listën e personave që vuajnë dënimin pranë I.E.V.P ka vetëm dy persona me vendbanim në Rrogozhinë, siç provohet edhe nga vetë shkresa që kjo I.E.V.P i ka dërguar Bashkisë Rrogozhinë.

-Akti Administrativ kolektiv lista e zgjedhësve për qendrën e votimit nr.2224/1 IEVP Rrogozhinë është akt administrativ kolektiv absolutisht i pavlefshëm sepse bie ndesh me lirinë kushtetuese të zgjedhjes së vendbanimit, bie ndesh gjithashtu me një dispozitë urdhëruese të Kodit Civil (neni 14 i tij) dhe nuk respekton hierarkinë e akteve normative sipas Kushtetutës që është baza e rendit juridik në Shqipëri (vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.2, date 3.02.2010 dhe nr.19, datë 3.05.2007), si dhe është ndryshuar në tejkalim të afatit të parashikuar në nenin

54, pika 1 e Kodit Zgjedhor. Lista e zgjedhësve për qendrën e votimit 2224/1 I.E.V.P Rrogozhinë është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm me përjashtim të emrave të 2 të dënuarve të cilët kanë vendbanimin sipas Kodit Civil në Bashkinë e Rrogozhinës, megjithatë në zbatim të pikës 3 të nenit 110 të Kodit të Procedurave Administrative dhe pikës 2 të nenit 62 të Kodit Zgjedhor, nuk do kishte një listë zgjedhësish për këtë qendër votimi pasi ajo nuk duhet të ishte ngritur për shkak të mosplotësimit të numrit minimal të zgjedhësve në të.

-Vlerësohet se të gjithë elementët e arsyetuar më sipër, duhet të sillnin si pasojë mospërfshirjen e rezultatit të votimit të qendrës së votimit nr.2224/1, I.E.V.P Rrogozhinë dhe për rrjedhojë pranimin e padisë sipas objekti të saj”.

#### 15. I padituri Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, prapësoi se:

“- Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve me shumicë votash rrëzoi kërkesën e ankuesit për kryerjen e rinumërimit dhe rivlerësimin tërësor të votave, pasi mungon shkak ligjor, por dy anëtarët e trupës së KAS në pakicë mbështetën kërkesën e ankuesit e cila nuk mund të hidhet në votim dhe nuk mund të pengohet marrja e provës. Rinumërimi dhe rivlerësimi i votave që u krye nga administrata e KQZ-së me pjesëmarrjen e vëzhguesve nga palët dhe nën mbikëqyrjen e KAS-it nuk zbuloi shkelje që mund të konsideroheshin cenim i rregullave në zbatimin e procedurës. Vetëm në një QV u konstatua tabulimi i dy votave më shumë për kandidatin e subjektit PS, gjë që kishte lidhje me pasqyrimin e parregullt në tabelë të dy votave të hedhura në kutinë e gabuar (pasqyrim i dyfishtë). KAS-i konstatoi nga këqyrja e votave të kontestuara në procesin e rinumërimit dhe rivlerësimit, se vlerësimi i votave ishte kryer nga grupet e numërimit sipas standartit. Në përfundim të procedurës, diferenca e votave midis kandidatit fitues dhe kandidatit të ankuesit zbriti nga 30 në 21 vota.

- Ankuesi kërkon të konstatohet pavlefshmëria absolute e listës së zgjedhësve, për shkakun se miratimi i listës së zgjedhësve për I.E.V.P Rrogozhinë vjen në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, konkretisht të Kodit Civil, i cili njeh vendqëndrimin për personat që vuajnë dënimin dhe jo vendbanimin. Kjo mënyrë arsyetimi e çon KAS-in në mënyrë të paevitueshme në konkluzionin se kërkesës për pavlefshmëri akti, sa i takon listës së zgjedhësve, i mungon shkak ligjor.

Neni 108 i KPrA përkufizon akte absolutisht të pavlefshme jo aktet që vijnë "në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi", sikurse referon ankuesi, por aktet që vijnë "në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:

- i. kompetencën e organit publik;
- ii. procedurën e nxjerrjes së tij; ose
- iii. formën ose elementët të tjerë të detyrueshëm të aktit" (shkronja "a" e nenit 108).

Kodi i Procedurave Administrative përcakton në pikën 2 të nenit 110 se "pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, të çdo të interesuari, nga organi publik që e ka nxjerrë atë, organi epror i tij apo organi që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative, si dhe nga gjykata kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit". Kjo dispozitë kërkon që kërkesa për pavlefshmërinë absolute të aktit të depozitohet pranë organit që ka nxjerrë aktin.

Pika 1 e nenit 56 të Kodit Zgjedhor përcakton se "zyra e gjendjes civile harton listën e zgjedhësve për çdo zonë qendre votimi jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve, duke nxjerrë nga të dhënat elektronike të RKGjC- së të gjithë shtetasit që do të mbushin moshën 18 vjeç deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve dhe që kanë vendbanimin në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e saj. Lista miratohet nga kryetari i njësisë përkatëse të qeverisjes vendore". Kjo dispozitë cakton organ përgjegjës për listën e zgjedhësve të I.E.V.P Rrogozhinë Kryetarit e Bashkisë Rrogozhinë dhe jo Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Kryetari i Bashkisë është organ i vetëqeverisjes vendore dhe gëzon pavarësi në ushtrimin e funksioneve.

Sa i takon listës së zgjedhësve, drejtimi metodologjik dhe mbikëqyrja e procesit të hartimit dhe shpalljes së listës bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila ka në përgjegjësi regjistrin kombëtar të gjendjes civile.

I takon ankuesit të çmojë nëse DPGJC është organ epror në kuptimin e pikës 2 të nenit 110 të KPrA, tek i cili ankuesi do të kishte mundësinë të depozitonte kërkesën për deklarimin absolutisht të pavlefshëm të vendimit të kryetarit të bashkisë Rrogozhinë, me të cilin është miratuar lista e zgjedhësve për QV-në e IEVP Rrogozhinë.

KAS-i është "organ kompetent për shqyrtimin e mjeteve ligjore administrative", në kuptimin e nenit 110 të K.Pr.Administrative KAS-i ka kompetencë shqyrtimin e kërkesave ankimore ndaj vendimeve të KZAZ-ve dhe të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndërkohë që as KZAZ-të, as Komisioneri nuk kanë kompetencë miratimin e listave të zgjedhësve. KAS-i nuk është organ kompetent për "konstatimin e pavlefshmërisë absolute të listës së zgjedhësve të QV-së nr. 2224/01". Edhe nga këndvështrimi i kompetencës ligjore të KAS-it mund të konfirmohet se, kërkesa ankimore nr. 80, e cila ka objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionerit nr. 531, datë 18.05.2023, futet në fushën e kompetencës së KAS-it, sepse ai është organ kompetent për të shqyrtuar kërkesat ankimore kundër vendimit të KZAZ-së ose të Komisionerit për shpalljen e rezultatit për zgjedhjet e organeve të njëjësive të qeverisjes vendore të juridiksionit të tyre (pikat 2 dhe 3 të nenit 124 të Kodit Zgjedhor). Por ankimi ndaj këtyre vendimeve bëhet ose për ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe për pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi.

- Sipas pretendimit të palës ankuese mbi kundërvënien midis nenit 14 të Kodit Civil dhe nenit 18 të ligjit për gjendjen civile, Kodi Civil ka bërë dallimin midis konceptit të "banimit" dhe atij të "vendqëndrimit". Këtë dallim Kodi Civil e sheh tek kohëqëndrimi "zakonisht ose të shumtën e kohës" në një vend. Ky është kriteri dhe vetëm kaq përcakton Kodi Civil. Për të shpjeguar "banimin" Kodi ka marrë për ilustrim termin "punë e përhershme", "shërbim i përhershëm", "pasuri", "interesa". Kjo nuk do të thotë se personi banon domosdoshmërisht vetëm atje ku ka punën apo pasurinë, aty ku shërben apo ku e lidhin interesat. Për të ilustruar "vendqëndrimin", Kodi ka marrë termin "punë e caktuar" "detyrë e caktuar", "shkollë e caktuar", "kurs i caktuar", "mjekim", "vuajtje e dënimit penal".

Sipas KAS-it, objekti i vendimit gjyqësor në këtë çështje nuk ka qenë diskutimi, nëse të burgosurit duhet apo jo ta gëzojnë të drejtën aktive të zgjedhjes, por diskutimi nëse vendbanimi është kriter i ligjshëm për kufizimin e kësaj të drejte në zgjedhjet vendore. Gjykata Kushtetuese e ka quajtur kriter të ligjshëm. Kodi Zgjedhor në fuqi kriterin e vendbanimit e ka caktuar kriter universal, të gjithë shtetasit me të drejtë vote votojnë aty ku kanë vendbanimin, pavarësisht nga lloji i zgjedhjeve. Të burgosurit me vendbanim në institucionin e vuajtjes së dënimit votojnë në QV-në e vendbanimit të tyre, kurse të burgosurit që nuk kanë vendbanimin në institucionin ku vuajnë dënimin, nuk mund të ushtrojnë të drejtën e tyre në këtë QV.

Në këto kushte, KAS-i konkludon se analiza ligjore e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, dispozitave të Kodit Civil dhe dispozitave të ligjit për gjendjen civile nuk krijon shkak për të kërkuar pavlefshmëri të zgjedhjeve në këtë QV, sepse zbatimi i secilës prej dispozitave që kanë lidhje me vendbanimin, regjistrimi i të burgosurve në gjendjen civile të bashkisë ku ndodhet institucioni dhe, për pasojë, përfshirja e tyre në listën e zgjedhësve nuk formon antikushtetueshmëri dhe nuk përbën shkelje.

- KAS konstaton se pretendimi i palës ankuese për zgjedhjet ku votojnë të burgosurit, sidomos ato ku vota e të burgosurve përcakton fituesin nuk janë zgjedhje të ndershme. KAS-i nuk mund të operojë me kategori diskutimi filozofik në trajtimin e ankesës. Votimi i të burgosurve është një e drejtë kushtetuese e afirmuar nga ligji, praktika zgjedhore dhe

jurisprudenca shqiptare. E drejta e të burgosurve për të votuar mbështetet nga Kushtetuta dhe ligji zgjedhor i Republikës së Shqipërisë.

Sipas konfirmimit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr. 6496/1 prot., datë 26.05.2023, lista prej 318 të burgosurish me të drejtë vote është pastruar nga subjektet që i nënshtrohen veprimit të ligjit nr. 138/2015, duke u reduktuar në numrin 118 persona të regjistruar në listën e zgjedhësve.

Në QV nr.2224/01 të I.E.V.P Rrogozhinë kanë votuar 99 të burgosur, sipas informacionit referuara shkresës së mësipërme të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Shkresa e këtij institucioni informon se 24 persona janë transferuar në I.E.V.P Rrogozhinë në periudhën nga data 01.01.2023 deri në datën 14.05.2023. Nga këta persona, 21 janë përfshirë në listën e zgjedhësve, kurse 3 kanë votuar me vendim gjykatë.

Shkresa nr.6496/1 prot., datë 26.05.2023 e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nuk jep informacion për datën e saktë të transferimit të 24 të burgosurve të sipërcituar. Ankuesi nuk shfaq interes në hetimin e kësaj të dhëne dhe nuk bëri përpjekje për të siguruar informacionin e duhur për secilin nga këta të dënuar, duke i hequr kështu çdo mundësi vetes për të verifikuar nëse ka pasur paligjshmëri në rastin e përfshirjes në votim të këtyre 24 apo 21 të burgosurve dhe për të kërkuar, nëse do ishte rasti, pavlefshërinë e zgjedhjeve në këtë QV, ndoshta për shkak të faktit se përfaqësuesit ligjorë të ankuesit u treguan në seancë të vendosur për të mos kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve.

Ngritja e QV-ve bëhet bazuar në nenin 62 të Kodit Zgjedhor, i cili kompetencën ia njeh kryetarit të bashkisë. Pika 5 e këtij neni përcakton se "Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore... cakton dhe shpall vendndodhjen e qendrës së votimit", kurse pika 2 e tij sqaron se "Institucionet e posaçme përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi. Qendra e votimit në këto institucione ngrihet kur në to ndodhen mbi 15 zgjedhës". Sipas pikës 4 "vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve tëfundit... Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, përshkak tëforcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja". Kushtet dhe kriteret që ky nen përcakton rezulton se janë respektuar dhe në këtë procedurë nuk ka shkak për të kërkuar pavlefshmëri për ngritjen e QV-së nr. 2224/01 të IEVP Rrogozhinë.

Shkelja e radhës së numërimit të kutisë së QV-së nr.2224/01, pasojë të vetme ka ndryshimin e radhës, por për shkak të saj nuk është përjashtuar asnjë zgjedhës nga votimi, nuk ka votuar askush kundër vullnetit të vet dhe nuk është tjetërsuar asnjë votë. Nga ana tjetër, shkelja e radhës së numërimit të kutisë nuk mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore (edhe ky është shkak pavlefshmërie), sepse ky fakt nuk ka asnjë ndikim në rezultat. Votat e hedhura në këtë QV kanë qenë ato që kanë qenë, përpara se kutitë të vendoseshin në rradhë përt'u numëruar.

Bazuar në këtë analizë ligjore dhe faktike, KAS-i rrëzoi kërkesën për heqjen nga tabela përmbledhëse të rezultatit për QV-në 2224/01 të I.E.V.P Rrogozhinë, si pa bazë ligjore kërkimi. Pavlefshmëria e zgjedhjeve në këtë QV rezulton e paprovuar.

Për sa më sipër, kërkohet: Rrëzimi i kërkesë padisë të paraqitur nga paditësi, Koalicioni "Bashkë Fitojmë" dhe z. Shkëlqim Hoxha, si të pambështetur në ligj dhe në prova. Lënien në fuqi të vendimit nr. 174, datë 06.06.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 80, datë 23.05.2023 të depozituar nga koalicioni "Bashkë Fitojmë".

#### 16. Personi i interesuar Partia Socialiste e Shqipërisë, prapësoi se:

“- Sipas objektit të padisë, kërkohet miratimi i Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023, pa përfshirë rezultatitn e QV Nr.2224/01 të I.E.V.P Rrogozhinë



dhe shpalljen fitues të kandidatit Shkëlqim Hoxha, për arsye se akti administrativ kolektiv lista e zgjedhësve për QV Nr.2224/01 të I.E.V.P Rrogozhinë është akt administrative absolutisht i pavlefshëm sepse:

- a) bie ndesh me lirinë kushtetuese të zgjedhjes së vendbanimit;
- b) bie ndesh me një dispozitë urdhëruese të Kodit Civil; (neni 14 i tij)
- c) nuk respekton hierarkinë e akteve normative sipas Kushtetutës që është baza e rendit juridik në Shqipëri;
- d) është ndryshuar në tejkalim të afatit të parashikuar nga neni 54, pika 1 e Kodit Zgjedhor.

-Po ashtu, sipas paditësit, në bazë të nenit 110/3 të K.Pr.A, meqënëse vetëm 2 nga të gjithë të dënuarit në liste kanë patur vendbanim në Rrogozhinë, nuk do të kishte listë zgjedhësish për këtë Q.V pasi ajo nuk duhet të ishte ngritur për shkak të mosplotësimit të numrit minimal (15) të zgjedhësve në të.

Krijimi i QV. Paditësi ka njohur legjitimitetin e Q.V Nr.2224/01, I.E.V.P Rrogozhinë. Sipas provave të administruara në proces, rezulton se Q.V Nr.2224/01, I.E.V.P Rrogozhinë nuk është një qendër votimi e hapur per herë të parë në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, por përkundrazi ka ekzistuar si e ngritur që prej kohësh.

Në interpretim të nenit 62/2 të K.Z rezulton se K.Z.A.Z Nr.43 e më tej K.Q.Z, për shkak se numri i të dënuarve në këtë I.E.V.P nuk ka rënë nën 15, nuk kanë patur shkak ligjor për krijimin e saj, pasi ishte e krijuar tashmë dhe IE.V.P Rrogozhinë funksionimin e saj sipas ligjit.

Duke qënë kjo një QV e krijuar më përpara, subjektet zgjedhore pikërisht për këtë qendër votimi kanë bërë propozimet tek K.Z.A.Z Nr.43 për emërimin e 7 anëtarëve të cilët janë votuar me vendim unanim (edhe nga PD dhe BF). Kështu, para dhe gjatë procesit zgjedhor K.Q.Z i ka vendosur në dispozicion kësaj QV të gjithë materialin zgjedhor (kuti, vula, kamera, fletë votimi etj) për të funksionuar normalisht sipas ligjit dhe pa pengesa. Në këtë kuptim, si KQZ ashtu edhe paditësi ka njohur legjitimitetin e Q.V Nr.2224/01, I.E.V.P Rrogozhinë. Sa më sipër, pretendimi i paditësit se “Zgjedhjet në IEVP Rrogozhinë janë bërë nga një komision qendër votimi që nuk ka një akt krijimi të tij” nuk qëndron. Po ashtu edhe pretendimi tjetër se për sa kohë që “për krijimin e KQV në IEVP Rrogozhinë nuk ka patur një akt administrativ të KSHZ, për pasojë nuk mund të ankimohet një akt që nuk ekziston” bie në kundërshtim me rrethanat e faktit, pasi paditësi nuk ka ankimuar vendimet e KZAZ pranë KAS sipas nenit 21/1/c të KZ.

- Në lidhje me pretendimin se në QV në nr.2224/01 të I.E.V.P Rrogozhinë kanë votuar persona që nuk mund të gëzonin ligjërish të drejtën për të qënë zgjedhës.

Paditësi argumenton se neni 165 i K.Z, i ndryshuar ka parashikuar se “1. Kryetarët e bashkive si dhe këshillat e bashkive zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë nga zgjedhësit me vendbanim në territorin e bashkisë.”, ndërsa Kodi Civil, neni 14, IE.V.P e konsideron si vendqëndrim të personit dhe jo vendbanim (neni 12 i KC).

Po sipas tij, përkufizimi që ligji Nr.10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, i bën vendbanimit në nenin 18/1/b “Regjistrimi i vendbanimit në institucionet e Forcave të Armatosura, të vuajtjes së dënimit dhe të kurimit mjekësor afatgjatë”.

1.Për shtetasit që:

a.kryejnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit apo qëndrojnë në institucionet e paraburgimit në pritje të vendimit gjyqësor;

dhe kur qëndrimi në institucionet përkatëse është më i gjatë se tre muaj, vendbanim konsiderohet adresa e institucionit përkatës.

nuk mund të konsiderohet pasi qartazi ka mospërputhje me KZ, i ndryshuar dhe K.Civil. Ligji Nr.10129/2009 nuk mund të konsiderohet për këtë çështje edhe për shkak të hierarkisë normative në interpretim të nenit 116 të Kushtetutës së R.SH dhe se në çështjen konkrete për elementin “vendbanim” do të zbatohen vetëm K.Z dhe KC,

*Në thelb të këtyre parashtrimeve, paditësi pretendon se të burgosurit kanë të drejtë vote vetëm për rastet e zgjedhjeve të përgjithëshme parlamentare dhe jo atyre vendore. Pikërisht për këtë shkak QV Nr.2224/1, I.E.V.P Rrogozhinë nuk duhet të numërohet.*

*Në vlerësimin e personit të interesuar, debati që propozon paditësi nuk ekziston. Kjo, pasi përfshirja e ligjit Nr.10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, në përmbajtje të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, është aq e madhe sa nuk lë vend për diskutim për sa pretendohet nga paditësi. Në rastin konkret flitet me të drejtën e votës së një votuesi që ndodhet në një I.E.V.P dhe pikërisht për këtë kategori shtetasish, për shkaqet që dihen, vendbanimi i tij sipas ligjit në fjalë është konsideruar I.E.V.P ku vuan dënimin.*

*Kurse në lidhje me ligjin e zbatueshëm për çështjet zgjedhore përgjigjia gjendet në nenin 1 dhe 2 pika 9 dhe 17 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, e më tej në përmbajtjen e neneve 27/5, 43, 44, 45 pika 1, 47 pika 3, 49 pika 1, e 64 pika 2 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar.*

*- Në lidhje me pretendimin se vendimi Nr.40/2007 të Gjykatës Kushtetuese përbën gur themeli sepse konsideron themelin e votës për përfaqësuesin e popullit në pushtetin që qëndron më afër tij, pikërisht për shkak të lidhjeve të qëndrueshme zgjedhës me vendbanim-i zgjedhur kryetar bashkie, personi i interesuar çmon se në vlerësimin e legjislacionit në fuqi të kohës, ky vendim gjyqësor trajton një rast kur legjislacioni ishte i ndryshëm nga ky aktual, si K.Z ashtu edhe ligji për gjendjen civile, ligji nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile. Ligji për gjendjen civile në fuqi sot ka hyrë në fuqi 2 vite pas vendimit në fjalë dhe sigurisht që KZ ka ndryshuar prej asaj kohe.*

*Sipas vendimit, rezulton se “Kërkuesi ka pretenduar papajtueshmërinë e fjalës “vendbanim ” me Kushtetutën, të parashikuar nga neni 63/3 i Kodit Zgjedhor, pasi kjo fjalë kushtëzon ushtrimin e të drejtës së votës me faktin që të burgosurit ose të paraburgosurit të jenë banorë në zonën ku vuajnë dënimin. Në këtë mënyrë, sipas kërkuesit, të burgosurit që kanë vendbanim të ndryshëm nga ai i vuajtjes së dënimit vendosen në pamundësi për të ushtruar të drejtën e votës, duke cenuar kështu një të drejtë të parashikuar nga neni 45/3 i Kushtetutës”.*

*Neni 45 , pika 2 dhe 3 i Kushtetutës në vitin 2003 parashikonte përjashtimin nga e drejta e zgjedhjes për shtetasit e deklaruar me vendim të formës së prerë si të paaftë mendërisht dhe se të dënuarit kanë vetëm të drejtën që të zgjedhin. Ndërsa ligji nr.9087, datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 63 parashikonte sic vijon: “Institucionet e posaçme”: 1.Institucionet e posaçme përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi. Qendra e votimit në këto institucione ngrihet edhe kur në to ndodhen nga 15 deri në 100 zgjedhës. 2.Në burgjet dhe në vendet e paraburgimit, për zgjedhjet dhe referendumet e përgjithshme, 40 ditë para datës së votimit, drejtuesi i institucionit përgatit listën e zgjedhësve dhe ia dorëzon atë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore në territorin e së cilës ndodhet institucioni i posaçëm. 3.Në burgjet dhe në vendet e paraburgimit, për zgjedhjet dhe referendums vendore, 40 ditë para datës së votimit, drejtuesi i institucionit përgatit listën e zgjedhësve me vendbanim në njësinë zgjedhore, ku ndodhet institucioni dhe ia dorëzon atë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse. 4. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, brenda 5 ditëve nga marrja e listës, sipas pikës 2 ose 3 të këtij neni, përfshin emrat e zgjedhësve të burgjeve dhe të vendeve të paraburgimit në listën e zgjedhësve të njësisë së tij dhe ia dërgon ato Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila, brenda 5 ditëve nga marrja e tyre, njofton njësitë përkatëse të qeverisjes vendore të vendbanimit të këtyre zgjedhësve t'i heqin ata nga lista e zgjedhësve të vendbanimit të tyre. 5.Në spitalet dhe në institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se tri ditë, procedurat e parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni kryhen dy javë përpara datës së zgjedhjeve”.*

*Por ligji nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar në atë kohë nuk përmbante parashikimin e nenit 18 të ligjit Nr.10129/2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar sot në fuqi, që zgjidh edhe çështjen e votimit të të dënuarve.*

Në këtë kuptim edhe interpretimi kushtetues sipas vendimit Nr.40/2007 është me natyrë pajtuese me Kushtetutën në kohën e dhënies së vendimit dhe nuk mund të ishte ndryshe.

Ndërkohë neni 45/3 i Kushtetutës së RSH në fuqi parashikon shprehimisht “Përfundimtar nga e drejta për t’u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t’u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dëbuar për një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike.” Dispozita kushtetuese më sipër, me natyrë kufizuese e të drejtave gjendet e konkretizuar në ligj nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në nenin 2 parashikon si me poshte:

1. Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak, dhe në çdo rast nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut, personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për: a) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë veprë penale, sipas neneve 73, 74, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b dhe 79/c, 86, 87, 88 paragrafi i dytë, 89/a, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 109, 109/b, 109/c, 110/a, 111, 114, 128/b, 135, 136, 140, 141, 143/a, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 278 paragrafin e parë, të pestë e të gjashtë, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284/a, 287 i lidhur me kryerjen e një krimi të parashikuar në këtë paragraf, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal; b) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë veprë penale, sipas neneve 110/c, 244, 245, 248, 248/a, 259, 260, 319, 319/ç, apo në fushën e zgjedhjeve, të parashikuar në Kreun X “ Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve ”, të Kodit Penal;... 4. Nuk kanë të drejtën të votojnë dhe të zgjedhin me votim të drejtpërdrejtë kandidatët për deputetë në Kuvend apo në organet e qeverisjes vendore personat që plotësojnë kushtet e parashikuara shkronjat “a” dhe “b” tëp ikës 1 të këtij neni.

Sipas komunikimeve të I.E.V.P Rrogozhinë drejtuar ZGJC Bashkia Rrogozhinë, rezulton se nga “...lista e plotë e të dënuarve janë hequr të gjithë ata që janë subjekt i ndalimeve sipas ligjit Nr.138/2015 ...”.

Pra, rezulton e qartë se në QV Nr.2224/01 nuk kanë votuar të dënuarit të cilëve iu kufizohet e drejta e votës sipas parashikimeve kushtetuese.

Përveç kësaj, paditësi në asnjë rast nuk ka pretenduar e provuar se të dënuarit kanë qënë të regjistruar si zgjedhës në listën e ndonjë zone qendre votimi tjetër.

- Neni 108 i K.Pr.A ka parashikuar rastet kur një akt administrativ është absolutisht i pavlefshëm<sup>2</sup> për pasojë në analizë të nenit 108 germa “a” vetëm për “kundërshtim të hapur dhe flagrant” nuk mund të flitet. Kjo konstatohet edhe nga analizat ligjore të thelluara që bën paditësi në padinë e depozituar në gjykatë.

Koncepti "kundërshtim" kërkon më tepër sesa thjeshtë mosrespektim të ndonjë dispozite ligjore. Në rast të kundërt, neni 109, i cili rendit një shumëllojshmëri të akteve të paligjshme, do të bëhej krejtësisht i pakuptimë. Nisur nga marrëdhëniet ndërmjet nenit 108 dhe 109, si dhe duke marrë parasysh pasojat juridike të pavlefshmërisë absolute, termi ligjore

<sup>2</sup> Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a.kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b.është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitemarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën veprë penale; c.ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç. në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.



”kundërshtim” kërkon një të metë të jashtëzakonshme të rëndë dhe serioze. Një e metë e tillë mund të përkufizohet si një e metë që është në kundërshtim flagrant me rendin ligjor dhe vlerat themelore të komunitetit, në të cilat bazohet rendi juridik, që rrjedhimisht do të ishte krejt e patolerueshme, nëse akti do të kishte sjellë pasojat e synuara juridike. Në këtë kontekst, nuk ka rëndësi vendimtare mosrespektimi i një dispozite të caktuar ligjore si e tillë, por vepra kundër rendit juridik në tërësi dhe parimeve të tij kushtetuese. Në çështjen në gjykim kërkohet të bëhet i pavlefshëm një akt administrativ i ZGJC Bashkia Rrogozhinë, lista zgjedhore, fuqia juridike e të cilit është njohur nga paditësi deri në daljen e rezultatit, dhe një akt administrativ për zhvillimin e zgjedhjeve në një QV ku prej vitesh është votuar dhe vetë të dënuarit, pa ndalesa kushtetuese për të votuar, që e kanë patur emrin vetëm në një listë zgjedhore, kanë shprehur vullnetin e tyre. Votimi në këtë formë e përmbajtje në I.E.V.P Rrogozhinë nuk është aspak kundër rendit juridik në tërësi dhe parimeve të tij kushtetuese.

Lind pyetja se çfarë kuptohet me shkelje flagrante të ligjit. Përgjigja për këtë jepet nga natyra e shkeljeve të përcaktuara nga neni 116 i Kodit të Procedurave Administrative, ku rastet e përfshira në të, duhen parë së bashku, duke nxjerrë në pah cilësinë e përbashkët që i karakterizon. Kur një akt administrativ nxirret nga një organ administrativ i paidentifikuar, ky fakt mund të konstatohet dukshëm dhe lehtësisht nga kushdo që bie në kontakt me këtë lloj akti. Pikërisht, cilësia e konstatimit nga kushdo në mënyrë të dukshme (apo të hapur) dhe lehtësisht të një të mete thelbësore të aktit administrativ (siç është identifikueshmëria e organit administrativ, kompetenca ligjore e organit administrativ për nxjerrjen e aktit administrativ, apo respektimi i formës dhe procedurës së kërkuar nga ligji për nxjerrjen e një akti administrativ), futet në sferën e pavlefshmërisë absolute të këtij akti.

Ndërsa çdo e metë tjetër e aktit që nuk mund të konstatohet që me shikim të parë, por për të cilën nevojitet hetim më i thelluar dhe vlerësim i fakteve që kanë çuar në nxjerrjen e aktit administrativ, përfshihet potencialisht në sferën e pavlefshmërisë relative të aktit administrativ. Për këtë të fundit veprojnë kufizimet ligjore të shterimit të rrugës së ankimit administrativ dhe afateve për paraqitjen e pretendimeve për pavlefshmëri, të cilat mund të kufizojnë proporcionalisht qasjen e palës në gjykatë, nëse nuk përmbush kushtet formale të sipërcituara.

Përdorimi i termave “e hapur dhe flagrante” do të thotë që e meta si e tillë, ashtu edhe shkalla e rëndë dhe serioziteti i saj i skajshëm janë lehtësisht të dallueshme me shikimin e parë të gjithkujt. Është e domosdoshme që çdo qytetar i zakonshëm pa ndonjë hetim apo vlerësim të vecantë juridik të arrijë në përfundimin se është e pamundur që një veprim i tillë të jetë në përputhje me rendin juridik.

Kështu, sa u parashtrua më sipër në lidhje me pavlefshmërinë absolute, konstatohet se palët nuk janë aspak përpara një pavlefshmërie të tillë. Po ashtu, në interpretim të nenit 110/2 të K.Pr.A5 gjendet me vend konstatimi i K.A.S kur thotë se “KAS i nuk është organ kompetent për “konstatimin e pavlefshmërisë absolute të listës së zgjedhësve të QVsë nr. 2224/01”. Në të njëjtën kohë, edhe Kolegji Zgjedhor nuk mund të konsiderohet si “...gjykata kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit” për të shqyrtuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ të Z.G.J.C, Bashkia Rrogozhinë. Zyra e Gjendjes Civile është një organ publik në kuptim të ligjit Nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar dhe mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative, veprimet administrative apo veprim tjetër administrativ, të dala prej saj janë në kompetencën lëndore të gjykatave të juridiksionit administrativ. Pra, akti administrative “lista zgjedhore për QV Nr.2224/01 I.E.V.P Rrogozhinë nuk është një akt administrativ i K.Q.Z. Sipas nenit 145 të K.Z, i ndryshuar, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka për kompetencë vetëm gjykimin e ankimeve kundër akteve administrativ të KQZ që janë thelbësisht të ndryshme me ato të ZGJC. Përfundimisht, për sa u parashtrua më sipër, në bazë të nenit 158, 3 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor kërkohet: Rrëzimi i plotë i padisë”.



## ARSYETIMI I KOLEGJIT

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, vlerësoi të përligjura vetëm një pjesë të pretendimeve të palës paditëse e që lidhen në thelb me pavlefshmërinë e zgjedhjeve në Qendrën e Votimit Nr.2224/1 të ZAZ Nr.43, Bashkia Rrogzhinë.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, Qendra e Votimit Nr.2224/1, përbën zonë të veçantë qendre votimi, për shkak të të qenurit institucion i posaçëm, në kuptim të Neneve 2 dhe 62 të Kodit Zgjedhor, që parashikojnë respektivisht se:

Neni 2

*“Përkufizime.*

*Në këtë Kod termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: ...*

*2. “Institucione të posaçme” janë burgjet, vendet e paraburgimit, si dhe spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se tri ditë”.*

Neni 62

*“2. Institucionet e posaçme përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi...”.*

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, përfshirja ose jo e një zone të veçantë qendre votimi, në zgjedhjet vendore për kryetar bashkie, dikton referimin fillimisht në Nenin 165 të Kodit Zgjedhor, që parashikon se:

*“1. Kryetarët e bashkive si dhe këshillat e bashkive zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë nga zgjedhësit me vendbanim në territorin e bashkisë”.*

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, zgjedhësit me vendbanim në territorin e bashkisë evidentohen vetëm nëpërmjet dokumenteve zyrtare që burojnë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile për çdo zonë të qendrës së votimit dhe që formojnë në këtë mënyrë, listën e zgjedhësve të qendrës së votimit, përfundim ky i konfirmuar nga përmbajtja e Neni 2/9 të Kodit Zgjedhor, që parashikon se:

*“9. “Listat e zgjedhësve” janë dokumente zyrtare të zgjedhësve, që burojnë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile për çdo zonë të qendrës së votimit, të hartuara në përputhje me këtë Kod”.*

Në kuptim të përmbajtjes së Nenit 44 të Kodit Zgjedhor, përfshirja e një personi në listën e zgjedhësve, kushtëzohet nga përmbushja ose jo prej tij e kritereve që:

- “ a) të ketë shtetësinë shqiptare;*
- b) të ketë mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në datën e zgjedhjeve;*
- c) Shfuqizuar;*
- ç) të jetë i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (në vijim RKGjC);*
- d) të ketë vendbanimin e regjistruar në territorin e një prej zonave të qendrave të votimit;*
- dh) të regjistrohet zgjedhës në listën e vetëm një zone qendre votimi”.*

Lidhur me hartimin e listës së zgjedhësve, Neni 46 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

*“1. Lista e zgjedhësve hartohet për çdo zonë qendre votimi dhe përmban të gjithë zgjedhësit që kanë vendbanimin e regjistruar në RKGjC në atë zonë qendre votimi. Përfshirja e zgjedhësit në listë bëhet mbi bazën e kodit të vendbanimit”.*

Me tej, sipas Nenit 56 të Kodit Zgjedhor:

*“1. Zyra e gjendjes civile harton listën e zgjedhësve për çdo zonë qendre votimi jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve, duke nxjerrë nga të dhënat elektronike të RKGjC-së të gjithë shtetasit që do të mbushin moshën 18 vjeç deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve dhe që kanë vendbanimin në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e saj. Lista miratohet nga kryetari i njësisë përkatëse të qeverisjes vendore.*

*2. Lista e zgjedhësve hartohet në përputhje me kriteret për numër zgjedhësish, të përcaktuara në pikën 2 të nenit 46 të këtij Kodi.*

*3. Lista e zgjedhësve i dërgohet, jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, KZAZ-së...”.*

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor tërheq vëmendjen mbi faktin se, ndërsa vendbanimi në territorin në juridiksion të të njësisë së qeverisjes vendore/bashkisë, përbën kusht për t’u cilësuar zgjedhës në procesin e votimit për kryetar bashkie, numri i zgjedhësve përbën kusht për ngritjen ose jo të qendrës së votimit, në një zonë qendre votimi.

Konkretisht, sipas Nenit 46/2 të Kodit Zgjedhor:

*“2. Një zonë qendre votimi ka jo më pak se 300 dhe jo më shumë se 1000 zgjedhës me vendbanim në territorin e saj”.*

Ndërsa sipas Nenit 62 të Kodit Zgjedhor:

*“Institucionet e posaçme përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi. Qendra e votimit në këto institucione ngrihet kur në to ndodhen mbi 15 zgjedhës”.*

Bazuar në dispozitat e mësipërme, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konstaton se, në Kodin Zgjedhor, parashikohet rregulli i përgjithshëm se, në procesin e votimit për kryetar bashkie, i garantohet pjesëmarrja çdo personi të cilit i konfirmohet vendbanimi në territorin e një prej zonave të qendrave të votimit të bashkisë.

Por, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, personi të cilit i konfirmohet vendbanimi në territorin e njësisë vendore të përfshirë në zgjedhje, nuk merr pjesë në procesin e votimit, nëse:

- Konfirmohet se vuan dënimin me burgim me vendim të formës së prerë, në një institucion të posaçëm;
- Institucioni i posaçëm ndodhet në territorin e njësisë vendore/bashkisë;
- Institucioni konfirmohet të ketë më pak se 15 zgjedhës.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, I EVP Rrogozhinë rezulton institucion ekzekutimi dënimesh me burgim, me vendndodhje në territorin e Bashkisë Rrogozhinë. Rrjedhimisht, I EVP Rrogozhinë përbën institucioni të posaçëm dhe për këtë shkak zonë të veçantë qendre votimi. Ngritja ose jo e qendrës së votimit në këtë institucion, diktonte konfirmimin paraprakisht të faktit të vuajtjes së dënimit në këtë institucion, të jo më pak së 15 personave, zyrtarisht me vendbanim në Bashkinë Rrogozhinë.

Thënë ndryshe, nëse në I EVP Rrogozhinë konfirmohej vuajtja e dënimit me burgim e më shumë se 15 të dënuarve jo me vendbanim në Bashkinë Rrogozhinë, ky fakt do përbënte rrethanë të mjaftueshme për mosngritje qendre votimi në këtë zonë të veçantë qendre votimi.

Në këtë kontekst, për të konkluduar mbi të qënurit ose jo të një personi që vuan një dënim, banor i njësisë administrative që perfshin në territorin e saj institucionin e posaçëm ku personi vuan dënimin, duhet referuar në Nenet 12 dhe 14 të Kodit Civil 1994, dispozita në fuqi, të pandryshuara prej kohës së miratimit të tyre dhe që parashikojnë respektivisht, se:

#### Neni 12

*“Banimi është vendi ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës.*

*Çdo person madhor ka të drejtë të caktojë lirisht vendbanimin e tij.*

*Personi nuk mund të ketë njëkohësisht me shumë se një vendbanim*

*Kjo dispozitë nuk zbatohet për vendbanimin e veprimtarisë së tregtarit”.*

#### Neni 14

**“Vendqëndrimi i personit është vendi ku ai ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për t’u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal, dhe për raste të tjera të kësaj natyre**

Në kuptim të përmbajtjes së dispozitave të sipërcituara, në fuqi prej vitit 1994, rezulton se, për personat fizikë, si subjekte të të drejtës civile, vendi/institucioni ku ata qëndrojnë për shkak të vuajtjes së një dënimi, konsiderohet vendqëndrim, të cilin, ndryshe nga vendbanimi, ata nuk kanë të drejtë ta caktojnë lirisht.

Rrjedhimisht, sipas Neni 62 të Kodit Zgjedhor, qendra e votimit në një zonë të veçantë qendre votimi, sikurse është I EVP Rrogozhinë, do të duhej të ngrihej vetëm në rast konfirmimi, në momentin e hartimit të listës së zgjedhësve, të faktit të vuajtjes së dënimit në I EVP Rrogozhinë të 15 zgjedhësve, pra të 15 personave me vendbanim të regjistruar në Bashkinë Rrogozhinë.

Për çdo person tjetër që, në momentin e hartimit të listës së zgjedhësve, rezultonte se vuante dënimin në I EVP Rrogozhinë, por nuk konfirmohej me vendbanim të regjistruar në Bashkinë Rrogozhinë, territori i kësaj bashkie konsiderohet vendqëndrim, rrethanë kjo përcaktuese e kufizimit në këtë rast, të të drejtës së tyre për të votuar për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren në këtë kontekst se, Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet Vendimit Nr.40 Dt.16.11.2007, ka marrë në shqyrtim dhe ka vendosur tashmë mbi kushtëzimin e ushtrimit të të drejtës së votës, me faktin që të burgosurit të jenë banorë në zonën ku vuajnë dënimin.

Gjykata Kushtetuese rezulton e investuar në këtë rast nga Avokati i Popullit me kërkesë me objekt: shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, të fjalës “vendbanim”, në Nenin 63, pika 3, të Kodit Zgjedhor, bazuar në argumentin se:

*“...të burgosurit që kanë vendbanim të ndryshëm nga ai i vuajtjes së dënimit, vendosen në pamundësi për të ushtruar të drejtën e votës, duke cenuar kështu një të drejtë të parashikuar nga neni 45/3 i Kushtetutës”.*

Në pjesën përshkruese të vendimit, Gjykata Kushtetuese evidenton se:

*“Në kërkesën para kësaj Gjykate kërkuesi ka parashtruar se ai është vënë në lëvizje për këtë shkelje nga vetë të burgosurit, të cilët nuk kanë pasur mundësi të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës”.*

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, Neni 63/3 i Kodit Zgjedhor në fuqi në kohën e investimit të Gjykatës Kushtetuese, i shfuqizuar tashmë, parashikonte se:

*“Në burgjet dhe në vendet e paraburgimit, për zgjedhjet dhe referendumet vendore, 40 ditë para datës së votimit, drejtuesi i institucionit përgatit listën e zgjedhësve me vendbanim në njësinë zgjedhore, ku ndodhet institucioni dhe ia dorëzon atë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse”.*

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren paraprakisht se, Neni 63/3 i Kodit Zgjedhor e kishte përftuar këtë përmbajtje, pas miratimit të ndryshimeve me Ligjin Nr.9341 Dt.10.1.2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.9297, datë 21.10.2004”, Neni 52, botuar në Fletore Zyrtare Nr.1 Dt.18.01.2005.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren gjithashtu se, Neni 63 i Kodit Zgjedhor 2003, para miratimit të ndryshimeve të vitit 2005, kishte këtë përmbajtje:

*“Zgjedhësit në Forcat e Armatosura dhe në Forcat e Rendit.*

*1. Menjëherë pas caktimit të datës së zgjedhjeve për Kuvendin, Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet e tjera qendrore kompetente, me kërkesë të KQZ-së, urdhërojnë komandantët e reparteve përkatëse të përgatisin listën e zgjedhësve që do të ndodhen në ato reparte në datën e zgjedhjeve.*

*2. Lista e zgjedhësve, që do të ndodhen në repartet ushtarake ose të rendit në datën e zgjedhjeve, i dorëzohet KZZ-së jo më vonë se 15 ditë pas caktimit të datës së zgjedhjeve.*

*3. KZZ-ja ia bashkëngjit listën e zgjedhësve, me vendqëndrim në repartet ushtarake ose të rendit, listës së zgjedhësve për njësinë zgjedhore përkatëse. Këta hiqen nga listat e zgjedhësve të vendbanimit të tyre, në përputhje me procedurat e caktuara nga KQZ-ja”.*

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor çmon të nevojshme të evidentojë paraprakisht edhe se, vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese rezulton të ketë referencë Nenin 45/e të Kushtetutës, dispozitë që, në kohën e shqyrtimit, kishte këtë përmbajtje:



*“3. Të dënuarit që janë duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë, kanë vetëm të drejtën për të zgjedhur”.*

Aktualisht, Neni 45/3 i Kushtetutës, parashikon se:

*“3. Përjashtohen nga e drejta për t’u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t’u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dëbuar për një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike”.*

Së fundi, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, në vendimmarrje, Gjykatës Kushtetuese i është referuar edhe Nenit 12 të Kodit Civil 1994 (cituat më lart).

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, bazuar në këto dispozita, Gjykata Kushtetuese ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke argumentuar se:

*“Lidhur me thelbin e kërkesës, pra për të arritur në përfundimin nëse termi “vendbanim” që përmban dispozita e nenit 63/3 e Kodit Zgjedhor është apo jo në përputhje me Kushtetutën, Gjykata Kushtetuese vlerëson se duhet të ndalet në konceptin e zgjedhjeve në përgjithësi e sidomos tek zgjedhjet vendore në veçanti.*

*E drejta e votës është një nga të drejtat themelore politike që gëzon individi. Kjo e drejtë ushtrohet nëpërmjet ngritjes së një sistemi zgjedhor që garanton fshehtësinë, lirinë dhe barazinë e votës duke i siguruar shtetasve qenien e tyre politikisht aktiv duke formuar në këtë mënyrë thelbin e rolit që duhet të kenë ata në një sistem demokratik. E drejta e votës është një element qendror i demokracisë dhe i shtetit të së drejtës. Kontributi kryesor i saj është garantimi i mundësisë për të gjithë zgjedhësit, pa bërë dallime mbi baza shtresash apo përkatësie në grupe të caktuara shoqërore ose mbi baza të tjera, që të ndikojnë në formimin e vullnetit politik në një shoqëri demokratike. Nga ushtrimi i të drejtës së votës nuk duhet përjashtuar asnjë pjesë sado e vogël e popullsisë, përveç rasteve të përcaktuara në ligjin themeltar të shtetit.*

*Megjithatë e drejta e votës nuk është absolute, ajo mund të bëhet objekt i kufizimeve. Në këtë këndvështrim, për vetë rëndësinë që merr kjo e drejtë në një shoqëri demokratike, kufizimet që i duhen bërë kësaj të drejte jo vetëm duhet të jenë të pakta, por ato duhen zbatuar brenda kufijve kushtetues.<sup>3</sup> E rëndësishme është që kufizimet të mos jenë të tilla që ta bëjnë jo efektiv ushtrimin e kësaj të drejte ose ta cenojë atë në thelbin e saj,<sup>4</sup> pasi e drejta e votës nuk është një privilegj që pushteti shtetëror ua njeh shtetasve, por një instrument për të zgjedhur mënyrën dhe personat që do të qeverisin vetë ata. Duke ushtruar të drejtën e votës zgjedhësit i krijohet mundësia të ndikojë në mënyrën dhe cilësinë e funksionimit të rendit juridik duke e bërë shtetasin më të përgjegjshëm për rolin që ai ka në drejtimin e jetës së vendit. Ky është në fakt edhe thelbi i demokracisë.*

*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 45 të saj, parashikon të drejtën e çdo individi mbi 18 vjeç të zgjedhë e të zgjidhet. Përjashtim bëjnë personat të cilëve u është hequr kjo e drejtë me vendim gjyqësor të formës së prerë për paaftësi mendore. Gjithashtu, paragrafi 3 i këtij neni parashikon se të dënuarit që janë duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë kanë*

<sup>3</sup> Vendim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aziz kundër Qipros, Nr. 69949/01 (2004).

<sup>4</sup> Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Mattheës kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 24833/94, (1999); Labita kundër Italisë Nr. 26772/95, (2000).

vetëm të drejtën për të zgjedhur. Ky parashikim kushtetues është brenda standardeve demokratike dhe bashkëkohore.

Gjykata Kushtetuese thekson se teoria e së drejtës kushtetuese si dhe praktika gjyqësore evropiane e quan të pranueshme dhe të justifikuar vendosjen e kriterëve të tilla si, mosha minimum ose vendbanimi në një zonë të caktuar, përfshirja në lista zgjedhësish apo pasja e shtetësisë së vendit ku zhvillohen zgjedhjet si dhe aftësia mendore për të shprehur vullnetin politik. Duke iu referuar edhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dispozita e nenit 1 Protokollit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vendet anëtare kanë një hapësirë të gjerë në hartimin e legjislacioneve të tyre për zgjedhjet natyrisht duke respektuar thelbin e së drejtës. Kufizimet që mund t'i vendosen kësaj të drejte duhet t'i përgjigjen një qëllimi legjitim dhe të mos jenë arbitrare apo joproporcionale.<sup>5</sup>

Neni 45/3 i Kushtetutës sonë ka shkuar tej parashikimeve minimale si detyrime që rrjedhin dhe nga aktet ndërkombëtare.<sup>6</sup> Këto akte, që synojnë garantimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike, u lënë shteteve anëtare një hapësirë të gjerë vlerësimi të mekanizmave që kanë në dispozicion për ta bërë ushtrimin e të drejtës së votës efektive edhe për grupe të posaçme.<sup>7</sup> Në këtë aspekt i është lënë vetë shteteve anëtare të vlerësojnë, midis të tjerave, edhe grupet e individëve që mund të përjashtohen nga e drejta e votës, psh., vendosja e një moshe më të lartë për të ushtruar të drejtën e votës ose vendosja e kriterëve të tilla si shtetësia.

Në rastin konkret, ligjvënësi ynë ka vendosur minimumin e kriterëve kufizues duke iu njohur të burgosurve të drejtën aktive të zgjedhjes. Pra, nga pikëpamja e garancisë kushtetuese formale e drejta e votës së të burgosurve është arritur nga dispozita e nenit 45/3 të Kushtetutës. Parashikimi i të drejtës së votës në përgjithësi dhe i grupeve të posaçme, siç konsiderohen të burgosurit, në veçanti, është shprehje e një demokracie politike dhe paraqet rëndësi për pjesëmarrjen e gjerë të votuesve në një proces të rëndësishëm.

Gjykata Kushtetuese konstaton se neni 63 i Kodit Zgjedhor vendos rregullat e ushtrimit të drejtës së votës për të burgosurit në zbatim të detyrimit që rrjedh nga dispozita e nenit 45/3 të Kushtetutës. Konkretisht, paragrafi 2 i nenit 63 parashikon votimin për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, kurse paragrafi 3 i këtij neni i referohet votimit në zgjedhjet për pushtetin vendor. Një nga dallimet midis këtyre dy dispozitave është se për zgjedhjet vendore ligjvënësi e ka lidhur ushtrimin e të drejtës së votës me vendbanimin, ndërsa për zgjedhjet e përgjithshme jo.

Arsyeja e këtij dallimi duhet kërkuar tek fakti se në zgjedhjet e përgjithshme votohet për anëtarët e organit ligjvënës, të cilët i përkasin të gjithë popullit. Një nga parimet kryesore të përfaqësimit popullor është edhe mungesa e mandatit detyrues të deputetit, pra deputeti përfaqëson jo zonën zgjedhore ku ai votohet por të gjithë zgjedhësit.

Ndryshe ndodh në rastin e zgjedhjeve vendore. Këtu synohet një lidhje më e ngushtë midis zgjedhësit dhe të zgjedhurit për vetë natyrën e organizimit dhe kompetencave të pushtetit lokal. Është pushteti vendor që kujdeset për zgjidhjen e problemeve aktuale të qytetarëve që lidhen me çështje të tilla si punësimi, kujdesi shëndetësor, arsimit parashkollor, pastrimi dhe gjelbërimi i mjediseve të njësisë vendore, etj. Për këtë arsye, votimi në zgjedhjet vendore trajtohet si pjesë e strukturës së demokracisë nga posht lart duke u mundësuar zgjedhësve pjesëmarrjen në qeverisje edhe në forumet më të vogla, përveç parlamentit kombëtar.<sup>8</sup> Në këtë këndvështrim, pranohet se pushteti lokal është më afër qytetarëve dhe këta të fundit janë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve në drejtimin e njësisë vendore ku ata kanë vendbanimin.

<sup>5</sup> Vendimi cituar më lart *Labita kundër Italisë*.

<sup>6</sup> Shih nenin 3 të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe nenit 25 të Paktit për të Drejtat Civile dhe Politike të OKB-së.

<sup>7</sup> *Froëin/Peukert*, Europäische Menschenrechtskonvention-Kommentar (1996) fq. 838.

<sup>8</sup> *Klaus Stern*, Das Staatsrecht der Bundesrepublik Deutschland, fq.424.

Sipas nenit 12 të Kodit Civil, banimi është "...vendi ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qendron zakonisht ose të shumtën e kohës." Në këtë kuptim, vendbanimi është pika qendrore e marrëdhënieve jetësore të një njeriu. Është kërkesë ligjore që një person të ketë një vendbanim kryesor, brenda një juridiksioni të caktuar, me qëllim që të votojë, të punësohet ose të presë përfitime të tjera brenda këtij juridiksioni. Kushti për të pasur vendbanimin në zonën zgjedhore është një nga kufizimet e të drejtës së votës, e cila bashkë me kriterin e shtetësisë synojnë të vendosin një lidhje direkte, qoftë edhe minimale, midis votuesit dhe rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Në këtë mënyrë sigurohet legjitimiteti i votës në një zonë të caktuar.<sup>9</sup>

Në këtë këndvështrim, duket me vend që neni 63/3 i Kodit Zgjedhor e lidh ushtrimin e të drejtës së votës për të burgosurit me konceptin e vendbanimit dhe jo me vendin e vuajtjes së dënimit ose vendqendrimit.

Gjykata Kushtetuese çmon se kushtëzimi i të drejtës së votës me konceptin e "vendbanimit" në përmbajtjen e dispozitës së nenit 63/3 të Kodit Zgjedhor nuk e bën atë antikushtetuese, përkundrazi ai garanton shprehjen direkte të vullnetit të zgjedhësit për drejtuesit e njësisë vendore ku ai banon. Si përfundim, në vijim të arsytimit të mësipërm, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese konstaton se mosushtrimi i të drejtës së votës nga të burgosurit dhe të paraburgosurit nuk është rrjedhojë e antikushtetutshmërisë së dispozitës së nenit 63/3 të Kodit Zgjedhor.

Për arsyet e paraqitura më lart, Gjykata Kushtetuese çmon se dispozita e paragrafit 3 të nenit 63 të Kodit Zgjedhor është në përputhje me nenin 45/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë".

Neni 132 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që parashikon se:

*"1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim".*

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, Vendimi Nr.40 Dt.16.11.2007 i Gjykatës Kushtetuese, nuk bën përjashtim nga zbatimi i dispozitës së mësipërme edhe në rastin në shqyrtim, përsa kohë që, sikurse evidentuam edhe më lart, nëpërmjet tij është shqyrtuar të qenurit ose jo kushtetues, të kufizimit/kushtëzimit të ushtrimit të të drejtës së votës, me faktin që të burgosurit të jenë banorë në zonën ku vuajnë dënimin.

Për tu theksuar është fakti se, Neni 45/3 i Kushtetutës, pas ndryshimeve të miratuara me Ligjin Nr.137/2015 Dt.17.12.2015, ka përfutur sot një përmbajtje që reflekton pikërisht, standardin e krijuar nga Gjykata Kushtetuese me Vendimin Nr.40 Dt.16.11.2007.

Sipas këtij standardi, shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ligjvënësi mund t'u parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur.

Ky kufizim rezulton i parashikuar shprehimisht në Kodin Zgjedhor, përsa kohë që, të pasurit **vendbanim** të regjistruar në territorin e një prej zonave të qendrave të votimit, përbën sipas Neni 44 (cituar më lart), kriter për përfshirjen e një personi në listën e zgjedhësve.

<sup>9</sup> Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, BVerfGE 36, 139/142.

Gjithashtu edhe Neni 165 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

*“1. Kryetarët e bashkive si dhe këshillat e bashkive zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë nga zgjedhësit **me vendbanim në territorin e bashkisë**”.*

Në vijim të arsyetimit së mësipërm, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se, pavarësisht kohës që ka kaluar nga dalja e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të cituar më sipër, në thelb edhe Kodi Zgjedhor në fuqi, e lidh të drejtën e votimit për kryetarët e bashkive, me të pasurit e vendbanimit në territorin e bashkisë përkatëse, element që është analizuar në mënyrë të detajuar nga Gjykata Kushtetuese, në kuadër të së drejtës themelore për të zgjedhur.

Në këtë kontekst, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson të zbatueshëm Vendimin Nr.40 Dt.16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese, sa herë që, (1) do të organizohen zgjedhje vendore në Republikën e Shqipërisë, (2) gjatë procesit të organizimit të tyre do konstatohen persona që vuajnë dënime penale në institucione të posaçme, (3) vendbanimi, sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor, do të jetë parashikuar shprehimisht si përbërës zgjedhor përcaktues të drejtës për të votuar të personit që vuan dënimin dhe (4) dispozita e Kodit Civil do të vijojë të ketë të njëjtën përmbajtje, duke konsideruar vendbanim, vendin ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës.

Thënë kjo, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor çmon të nevojshme të evidentojë faktin se, nga palët ndërgjyqëse nuk është vënë në diskutim administrativisht apo gjyqësisht, fakti se:

- Bashkia Rrogozhinë, nëpërmjet Shkresës Nr.532/1 Prot. Dt.07.03.2023, i ka përcjellë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, propozimin për krijimin e Qendrës së Votimit të Posaçëm Nr.2224/01, në IEVP Rrogozhinë;
- Drejtori i IEVP Rrogozhinë, nëpërmjet Shkresës Nr.1491 Prot. Dt.21.03.2023, përcjellë Zyrës së Gjendjes Civile të Bashkisë Rrogozhinë, ka konfirmuar:
  - Vuajtjen e dënimit në këtë institucion, të 318 të dënuarve siguri e zakonshme;
  - Heqjen nga lista e plotë e të dënuarve, të një pjese të tyre, bazuar në përjashtimet e Ligjit Nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
  - Listën më 118 të dënuar të mbetur, me qëllim vlerësimin nga Zyra e Gjendjes Civile, të përfshirjes ose jo të tyre në zgjedhjet e datës 14 maj 2023;
- Lista më 118 të dënuar bashkëngjitur Shkresës Nr.1491 Prot. Dt.21.03.2023 të IEVP Rrogozhinë, që pasqyron vendbanimin e secilit prej tyre, konfirmon deri në këtë datë, vetëm një të dënuar më vendbanim në Rrogozhinë (SH.S i datëlindjes 11.02.1989);
- Shkresa Nr.1491 Prot. Dt.21.03.2023 e IEVP Rrogozhinë, rezulton të jetë protokolluar në Bashkinë Rrogozhinë me NR.3863 Prot Dt.24.03.2023;
- KQZ-ja nuk rezulton të ketë konfirmuar me vendim, krijimin e KQV-së së posaçme në IEVP Rrogozhinë, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023;



- Për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022, mbi propozimin e KZAZ Nr.43/Bashkia Rrogozhinë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka disponuar Vendimin Nr.125 Dt.04.03.2022, duke vendosur:

*“1. Të autorizojë KZAZ-në nr.43, bashkia Rrogozhinë që me vendim, të krijojë dhe emërojë Komisionin e Qendrës së Posaçme të Votimit nr. 2224/1.*

*2. Të autorizojë KZAZ-në nr. 43, bashkia Rrogozhinë të marrë nga 20 (njëzet) fletë votimi nga QV nr.2225, QV nr.2226 dhe QV nr.2226/1 dhe t'i dorëzojë në KQV-në nr. 22241. Në total do të merren 60 (gjashtëdhjetë) fletë votimi për të pajisur QV nr.22241.*

*3. KZAZ nr.43 të marrë masat që QV nr.22241 të pajiset me fletët e votimit nga QV-të e cituara në pikën 2.*

*4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.*

*5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve”;*

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me Shkresën Nr. 6496/1 Prot. Dt.26.05.2023, ka konfirmuar se:

*“Gjatë procesit zgjedhor, ka patur pretendim nga Bashkia Fushë-Krujë për të mos regjistruar zgjedhës nga burgju për arsye se janë zgjedhje vendore dhe për këtë kemi dërguar e-mail Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 27.03.2023, i cili po me datën 27.03.2023, ora 16:27, sqaron “Ndërsa neni 43 ngarkon KZAZ-në, t’i propozojë KQZ-së krijimin e KQV-ve (Komisionit të Qendrës së Votimit) të posaçme në institucionet e posaçme. Këto komisione kanë të njëjtën përbërje dhe të njëjtat përgjegjësi si dhe vetë KQV-ja. Përsa më sipër Kodi Zgjedhor nuk ka asnjë parashikim për ndalimin e krijimit të qendrave të votimit për zgjedhjet vendore. Në këto kushte në rast se plotësohen kriteret ligjore për listën e zgjedhësve në zonën e qendrës së votimit I.E.V.P, ato qendra votimi ngrihen në përputhje me parashikimet e sipërcituara”.*

Bazuar në faktet e mësipërme, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konstaton se, vendbanimi, si përbërs i gjendjes civile për 117 persona që vuanin dënimin në IEVP Rrogozhinë, rezulton të jetë ndryshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Bashkia Rrogozhinë, duke i kthyer ata në banorë të Bashkisë Rrogozhine pas datës 21.03.2023.

Rrjedhimisht, pjesë e listës së zgjedhësve për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë rezulton të jenë bërë edhe 117 zgjedhës, veprim i bazuar në Nenin 18 të Ligjit Nr.10129 Dt.11.05.2009 “Për gjendjen civile”, që parashikon se:

*“Regjistrimi i vendbanimit në institucionet e Forcave të Armatosura, të vuajtjes së dënimit dhe të kurimit mjekësor afatgjatë.*

*1. Për shtetasit që:*

*a) kryejnë shërbimin ushtarak apo kryejnë detyra në Forcat e Armatosura dhe banojnë brenda territorit të njësisë së Forcave të Armatosura;*

*b) kryejnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit apo qëndrojnë në institucionet e paraburgimit në pritje të vendimit gjyqësor;*

*c) qëndrojnë pa ndërprerje në institucione shëndetësore, me qëllim kurimin afatgjatë; dhe kur qëndrimi në institucionet përkatëse është më i gjatë se tre muaj, vendbanim konsiderohet adresa e institucionit përkatës.*

2. Institucioni përgjegjës njofton zyrën kompetente të gjendjes civile, jo më vonë se 48 orë nga regjistrimi në institucion i shtetasit. Vendbanimi i shtetasit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, regjistrohet drejtpërdrejt nga zyra e gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin përkatës, me marrjen e njoftimit nga institucioni.

3. Kur përfundon qëndrimi i shtetasve në një nga institucionet e përcaktuara në këtë nen, institucioni përkatës njofton zyrën e gjendjes civile brenda juridiksionit të tij territorial, në lidhje me këtë fakt, brenda 5 ditëve. Nëpunësi i gjendjes civile kryen veprimet në Regjistrin Kombëtar, sipas rregullave të përcaktuara nga ministri që mbulon gjendjen civile.

4. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat e njoftimit nga ana e institucioneve për kategoritë e shtetasve të përcaktuar në këtë nen”.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, nga përjasja e dispozitave të Kodit Zgjedhor me Nenin 18 të Ligjit Nr.10 129 Dt.11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, rezulton se, procedura e kthimit të vendqëndrimit në vendbanim, është e ndryshme nga procedura e miratimit të listes së zgjedhësve për organet e qeverisjes vendore dhe i paraprin asaj, në kuptimin që, Zyra e Gjendjes Civile, vendbanimin si përbërës zgjedhor, nuk e formon për shkak të zgjedhjeve, në momentin e miratimit të listës së zgjedhësve, por e merr të gatshëm këtë përbërës, si e dhënë e rezultuar nga procedura e kryer më herët prej saj, në zbatim të Nenit 18 të Ligjit Nr.10 129 Dt.11.05.2009.

Konkretisht në Nenin 56 të Kodit Zgjedhor, parashikohet se:

*“Zyra e gjendjes civile harton listën e zgjedhësve për çdo zonë qendre votimi jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve, duke nxjerrë nga të dhënat elektronike të RKGjC-së të gjithë shtetasit që do të mbushin moshën 18vjeç deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve dhe që kanë vendbanimin në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e saj. Lista miratohet nga kryetari i njësisë përkatëse të qeverisjes vendore”.*

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor çmon të nevojshme të evidentojë në këtë kontekst, faktin se, Neni 6 i Ligjit Nr.10 129 Dt.11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, parashikon se:

*“1. Përbërësit e gjendjes civile janë: emri e mbiemri, numri personal, datëlindja, vendlindja, gjinia, shtetësia, raportet e atësisë e amësisë, gjendja civile, vdekja, shpallja i/e zhdukur, vendbanimi, vendqëndrimi dhe fakte të tjera, të parashikuara me ligj.*

*2. Shtetësia shqiptare, si përbërës i gjendjes civile, është elementi i vetëm dallues nga shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi.*

*3. Elementet përbërëse në dokumentet e shërbimit të gjendjes civile kanë përparësi ndaj të njëjtave elemente të çdo akti tjetër, shtetëror ose privat dhe janë të detyrueshme të respektohen”.*

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se, në kuptim të përmbajtjes së dispozitës së sipërcituar, vetë ligji për gjendjen civile, në përputhje me Kushtetutën dhe Kodin Civil, i dallon nocionet “vendbanim” dhe “vendqëndrim”, si përbërës të ndryshëm të gjendjes civile, duke ometuar të rregullojë pasqyrimin në regjistrin e gjendjes civile, të përbërësit “vendqëndrim”.

Nisur nga ky ometim, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se, “vendbanimi” i të dënuarve me burgim apo i të paraburgosurve, sipas Nenit 18 të Ligjit Nr.10129 Dt.11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, pavarësisht problematikës së teknikës legjislative, i referohet kuptimit të vendqëndrimit, në përputhje edhe me të drejtën kushtetuese për të zgjedhur lirisht vendin e banimit dhe me Kodin Civil, që bën të njëjtin parashikim.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor tërheq vëmendjen mbi faktin se, zbatimi korrekt i kësaj dispozite, edhe sikur të pranohet se ndryshimi lidhet me vendbanimin, jo me vendqëndrimin, diktonte ndryshimin e vendbanimit për 117 persona që vuanin dënimin në IEVP Rrogozhinë, jo më vonë se 48 orë nga regjistrimi i tyre në këtë institucion, çka nuk rezultoi në rastin në shqyrtim.

Sikurse evidentuam edhe më lart, deri në disponimin nga IEVP Rrogozhinë të Shkresës Nr.1491 Prot. Dt.21.03.2023, pa asnjë përjashtim, këto 117 persona rezultojnë me vendbanim të regjistruar jo në Bashkinë Rrogozhinë.

Për sa më sipër, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se, parashikimet e Kodit Zgjedhor, Kodit Civil dhe Vendimi Nr.40/2007 i Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të shmangen së zbatuari lidhur me përbërësin zgjedhor “vendbanim”, për shkak të parashikimeve të Ligjit Nr.10129 Dt.11.05.2009 “Për gjendjen civile”, përsa kohë që ky ligj, pavarësisht mënyrës së interpretimit nga KAS, nuk i heq personit fizik, të drejtën ekskluzive të zgjedhjes së vendbanimit, parashikuar në Nenin 138 të Kushtetutës dhe Nenin 12 të Kodit Civil, që parashikojnë respektivisht, se:

*“1. Kushdo ka të drejtë të zgjedhë vendbanimin si dhe të lëvizë lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit”.*

dhe

*“Çdo person madhor ka të drejtë të caktojë lirisht vendbanimin e tij”.*

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, të qenurit e 117 personave që vuanin dënimin në IEVP Rrogozhinë, deri më datë 21.03.2023, me vendbanime të ndryshme nga Bashkia Rrogozhinë, konfirmon faktin e:

- Ushtrimit prej tyre të të drejtës së zgjedhjes/caktimit të vendbanimit;
- Pamundësinë e ushtrimit prej tyre të të drejtës së votimit, për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Rrogozhine.

Në këtë kuptim, Kolegji Zgjedhor vlerëson se, fakti që këta 117 persona kanë patur të regjistruar vendbanimin në zona të tjera zgjedhore, përbën një tjetër pengesë për të ushtruar të drejtën e votimit në ZAZ Nr.64, ku përfshihet institucioni i posaçëm në të cilin ata janë duke vuajtur dënimin.

Konkretisht, Neni 66/1 i Kodit Zgjedhor parashikon detyrueshmërinë e shpalljes së listës së zgjedhësve, jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve.

Nga ana tjetër, në pikën 4 të kësaj dispozite, parashikohet se:

*“Lista e zgjedhësve nuk ndryshon në asnjë rrethanë dhe për asnjë shkak pas afatit të parashikuar në pikën1. Programi kompjuterik ndërtohet në një mënyrë të tillë që nuk lejon asnjë ndryshim në listën e zgjedhësve,pavarësisht nga ndryshimet në përbërësit e gjendjes civile në RKGjC”.*

Kolegji Zgjedhor vëren se, as ndryshimi i mëvonshëm i vendbanimit, nuk ligjëron personin të votojë në qendrën e votimit që i përket vendbanimit të tij të ri.

Një ndalim i tillë parashkohet shprehimisht në pikën 2 të Nenit 67 të Kodit Zgjedhor, që parashikon se:

*“Në rast se zgjedhësi ndryshon vendbanimin pas shpalljes së listës së zgjedhësve, lista nuk ndryshon dhe zgjedhësi voton në qendrën e votimit ku ka emrin në listën e miratuar. Në rast se zgjedhësi paraqet kërkesë në gjykatë në kushtet e kësaj pike, kërkesa rrëzohet”.*

Nga ana tjetër, ligjvënësi ka kushtëzuar edhe paraqitjen e kërkesës për ndryshimin e përbërësve zgjedhorë (në të cilin bën pjesë edhe kodi i banimit në kuptim të Nenit 45 pg.1 shkorja “ë”), jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, fakt që parashkohet shprehimisht nga neni 54 pika 1 e Kodit Zgjedhor.

Në rastin konkret, shkresa e I EVP Rogozhinë për përcjelljen e listës së të dënuarve që nuk kanë pengesa për të votuar, në funksion të ndryshimit të vendbanimit dhe përfshirjen e tyre në listën e zgjedhësve të Bashkisë Rogozhinë, mban datën 21.03.2023, duke tejkaluar afatin ligjor jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve.

Përveç sa më sipër, në Shkresën Nr.6496/1 Prot Dt.26.05.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, është pasqyruar fakti se, nga lista e të dënuarve që vuajnë dënimin në I EVP Rogozhinë dhe që janë përfshirë në listën e zgjedhësve, rezulton se 24 prej tyre janë transferuar pranë I EVP Rogozhinë në periudhën 01.01.2023-14.05.2023.

Duke marrë në konsideratë faktin që lista e zgjedhësve shpallet jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhësve dhe është e pandryshueshme, konstatohet se minimalisht 24 persona të dënuar, janë përfshirë në listën e zgjedhësve pa plotësuar as afatin 3 mujor të vendqëndrimit në I EVP Rogozhinë, si kriter i parashikuar nga Ligji Nr.10129 Dt.11.05.2009 “Për gjendjen civile”, ku referon pala e paditur në mbrojtjen e saj.

Në lidhje me sa më sipër, Kolegji Zgjedhor vlerëson se, pala e paditur ka dështuar të provojë faktin se në rastin konkret, qendra e votimit në I EVP Rogozhinë, është ngritur në respektim të dispozitave të Kodit Zgjedhor, sa i takon plotësimin të kushtit që në këtë instiucion, të kishte të paktën 15 zgjedhës me të drejtë votimi, me vendbanim të regjistruar në Bashkinë Rogozhinë, në momentin e ngritjes së qendrës së votimit.

Për sa më sipër, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor nuk përlijt përfundimin e KAS, se:

*“20. Ankuesi ka parë një kundërvënie midis nenit 14 të Kodit Civil dhe nenit 18 të ligjit për gjendjen civile, të cilën KAS-i nuk e sheh...”*

*Terminologjinë e përgjithshme dhe të pa specifikuar të Kodit Civil, ligji për gjendjen civile e ka përkthyer në terminologji specifike dhe të detajuar. Neni 18 i tij ka vendosur si kriter dallues midis vendbanimit dhe vendqëndrimit qëndrimin për më shumë se 3 muaj në një vend të caktuar. Nëse personi jeton më shumë se tre muaj në një vend, atëherë, për efekt të ligjit do konsiderohet se ai aty jeton “zakonisht ose të shumtën e kohës”. Midis Kodit Civil dhe ligjit për gjendjen civile nuk ka kundërvënie.*

*21. KAS-i, ndryshe nga ankuesi, nuk sheh kundërvënie as midis vendimit nr.40, datë 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese dhe nenit 18 të ligjit për gjendjen civile. Analiza e vendimit të Gjykatës Kushtetuese mund të bëhet, duke e vendosur atë në kontekstin historik. Gjykata*



*Kushtetuese atëkohë ishte vënë në lëvizje për shkakun se ligji zgjedhor i kohës (ligji nr.9341, datë 01.10.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë””) i kishte hequr të drejtën për të votuar në zgjedhjet vendore një pjesë të të burgosurve, duke ia njohur këtë të drejtë vetëm të burgosurve me vendbanim në njësinë administrative ku ndodhet institucioni i vuajtjes së dënimit. Pretendimi i Avokatit të Popullit ishte se “të burgosurit që kanë vendbanim të ndryshëm nga ai i vuajtjes së dënimit vendosen në pamundësi për të ushtruar të drejtën e votës, duke cënuar kështu një të drejtë të parashikuar nga neni 45/3 i Kushtetutës”.*

22. Pra, objekti i vendimit gjyqësor në këtë çështje nuk ka qenë diskutimi, nëse të burgosurit duhet apo jo ta gëzojnë të drejtën aktive të zgjedhjes, por diskutimi nëse vendbanimi është kriter i ligjshëm për kufizimin e kësaj të drejte në zgjedhjet vendore. Gjykata Kushtetuese e ka quajtur kriter të ligjshëm. Kodi Zgjedhor në fuqi kriterin e vendbanimit e ka caktuar kriter universal, të gjithë shtetasit me të drejtë vote votojnë aty ku kanë vendbanimin, pavarësisht nga lloji i zgjedhjeve. Të burgosurit me vendbanim në institucionin e vuajtjes së dënimit votojnë në QV-në e vendbanimit të tyre, kurse të burgosurit që nuk kanë vendbanimin në institucionin ku vuajnë dënimin nuk mund të ushtrorjnë të drejtën e tyre në këtë QV. Kodi Zgjedhor është në përputhje të plotë me vendimin nr.40, datë 16.11.2007, kurse ligji për gjendjen civile nuk krijon dot konflikt, sepse ai thjesht saktëson konceptin e vendbanimit, por nuk kufizon të drejtën për të votuar. Në këto kushte, KAS-i konkludon se analiza ligjore e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, dispozitave të Kodit Civil dhe dispozitave të ligjit për gjendjen civile nuk krijon shkak për të kërkuar pavlefshmëri të zgjedhjeve në këtë QV, sepse zbatimi i sejcilës prej dispozitave që kanë lidhje me vendbanimin, regjistrimi i të burgosurve në gjendjen civile të bashkisë ku ndodhet institucioni dhe, për pasojë, përfshirja e tyre në listën e zgjedhësve nuk formon antikushtetueshmëri dhe nuk përbën shkelje”.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren gjithashtu se, KQZ-ja nuk rezulton të ketë konfirmuar me vendim, krijimin e KQV-së së posaçme në IEVP Rrogozhinë, për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, rrjedhimisht Qendra e Votimit Nr.2224/1 rezulton e ngritur pa vendim, çka bie ndesh me parashikimet e Nenit 43 të Kodit Zgjedhor, sipas përmbajtjes së të cilit:

*“KZAZ-ja, në përputhje me këtë Kod dhe me udhëzimet e KQZ-së, i propozon KQZ-së krijimin e KQV-ve të posaçme në institucionet e posaçme. Këto komisione kanë të njëjtën përbërje dhe të njëjtat përgjegjësi si edhe KQV-ja”.*

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konstaton se, në Qendrën e Votimit 2224/1:

- Janë konfirmuar 118 zgjedhës;
- Nuk konfirmohet që 15 prej tyre të kenë qenë me vendbanim të regjistruar në Bashkinë Rrogozhinë, si rezultat i një procedure që bazohet në ushtrimin prej tyre të të drejtës për të zgjedhur/caktuar vendbanimin.

Konfirmimi i këtyre fakteve, në raport me analizën e mësipërme ligjore, vlerësohet nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, shkelje e ligjit, që ka cënuar rëndë procesin zgjedhor, në kuptim të Nenit 160 të Kodit Zgjedhor, që parashikon se:

*“1. KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të pavlefshme **në një** apo më shumë qendra votimi, në rast se:*

*a) kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor...”.*

Në interpretim të dispozitës ligjore të mësipërme, Kolegji Zgjedhor vlerëson se, ngritja e një qendre të posaçme votimi, në kundërshtim me procedurën e parashikuar nga ligji (pa vendim të KQZ-së), përbën shkelje që çënon rëndë procesin zgjedhor.

Ngritja e qendrave të posaçme të votimit në institucionet e posaçme (sikurse janë institucionet e vuajtjes së dënimit), në kuptim të Nenit 43 të Kodit Zgjedhor, bëhet vetëm me vendim të KQZ-së dhe jo me vendim të Kryetarit të Bashkisë në juridiksionin e së cilës ndodhet ajo qendër votimi. Ky i fundit ka të drejtë të caktojë vendodhjen e qendrës së votimit, duke iu referuar të njëjtës vendodhje që ka patur në zgjedhjet e kaluara, por kurrësi krijimin e kësaj qendre votimit. Ndryshe nga qendrat e zakonshme të votimit të cilat si rregull mbeten të pandryshuara, në rastin e qendrave të posaçme të votimit, është i nevojshë konstituimi i tyre në çdo periudhë zgjedhore, pas verifikimit rishtazi të plotësimit të kushteve ligjore për krijimin e tyre.

Në rastin konkret nuk rezulton që KQZ të ketë verifikuar plotësimin e kushteve ligjore për krijimin e Qendrës së Votimit Nr.2224/1 dhe të ketë nxjerrë vendim për krijimin e kësaj qendre votimi.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, në vendimin objekt padie, KAS ka evidentuar dhe konkluduar se:

*“24. Ankuesi ngriti pretendimin se zgjedhjet ku votojnë të burgosurit, sidomos ato ku vota e të burgosurve përcakton fituesin nuk janë zgjedhje të ndershme. “Ka një pyetje qëndrore, të cilës duhet t’i japim përgjigje: A është e drejtë, e ndershme dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare që kryetari i bashkisë të përcaktohet vetëm nga vota e të burgosurve?”, shkruan ankuesi në kërkesën ankimore. Në mbështetje të këtij pozicionimi, ankuesi referon tek debate apo studime nga Mbretëria e Bashkuar, por ato nuk mund të ngrihen në nivelin e standartit ndërkombëtar që evokon vetë ankuesi në pyetjen e vet retorike.*

*25. KAS-i nuk mund të operojë me kategori diskutimi filozofik në trajtimin e ankesës. Votimi i të burgosurve është një e drejtë kushtetuese e afirmuar nga ligji, praktika zgjedhore dhe jurisprudenca shqiptare. Në këtë kuptim, votimi i të burgosurve është standart shqiptar, të cilin KAS-i nuk ka pushtet ligjor që t’a vërë në diskutim. Faktet e çështjes provojnë se kandidati fitues nuk është zgjedhur “me votat e të burgosurve”, por me votat e shumicës së zgjedhësve që kanë marrë pjesë në votim, është zgjedhur me shumicë absolute votash.*

*29...Në listën e zgjedhësve të IEVP Rrogozhinë kanë qenë të regjistruar 119 zgjedhës, gjë që plotëson kriterin numerik për ngritjen e QV-së, në këtë institucion janë kryer procedura votimi rregullisht në të shkuarën dhe adresa e QV-së mbetet e pandryshuar. Ngritja e QV-së është bërë me akt të kryetarit të bashkisë”.*

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, përkundër qëndrimit të KAS, konstaton se, kandidati fitues rezulton të jetë zgjedhur me votat e shumicës së zgjedhësve që kanë marrë pjesë në votim, edhe pse për një pjesë të tyre, ushtrimi i të drejtës për të votuar, ndalohej me ligj.

Për sa më sipër, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, konkludon mbi pavlefshmërinë e zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, në Qendrën e Votimit Nr.2224/1.

Në raport me rregullimin e pasojave, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i referohet Nenit 161 të Kodit Zgjedhor, që parashikon se:

*“1. Pas përfundimit të procesit të ankimit, jo më vonë se 3 ditë nga nxjerrja e rezultatit të zonës zgjedhore, KQZ-ja kryesisht ose me kërkesë të subjektit, shpall të pavlefshme dhe urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve **në të gjithë zonën zgjedhore**, kur pavlefshmëria e shpallur në një ose disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi, ndikon në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore ose në shkallë vendi.*

*2... Për zgjedhjet për kryetar të qeverisjes vendore ndikim në rezultat do të konsiderohet **kur numri i zgjedhësve në qendrat e shpallura të pavlefshme është më i madh se diferenca midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme**.*

*4. Në rast pavlefshmërie për shkelje të ligjit, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 160, apo kur votimi është shpallur i pavlefshëm, sipas paragrafit të dytë të pikës 4 të nenit 138 të këtij Kodi dhe kur procesi i votimit ka përfunduar, sipas këtij Kodi, për përcaktimin e ndikimit merret në konsideratë numri i zgjedhësve që kanë votuar në qendrën e votimit të shpallur të pavlefshme”.*

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, prej palëve ndërgjyqëse nuk vihet në diskutim fakti se, deri në momentin e numerimit të votave në Qendrën e Votimit Nr.2224/1, paditësi Shkëlqim Hoxha, kandidat i Koalicionit “Bashkë Fitojmë” për Bashkinë Rrogozhinë, rezultonte me numër votash në avantazh në raport me kandidatin e personit të tretë.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren gjithashtu se, prej palëve ndërgjyqëse nuk vihet në diskutim as fakti se, votat në Qendrën e Votimit Nr.2224/1 rezulton të jenë numëruar të fundit.

Në vlerësimin e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, ky fakt bie ndesh me Nenin 116 të Kodit Zgjedhor, që parashikon se:

*“1. KZAZ-ja merr vendim për fillimin e numërimit të votave vetëm pasi të ketë marrë në dorëzim të gjitha kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit nga të gjitha qendrat e votimit nën juridiksionin e saj.*

*2. Anëtarët e grupeve të numërimit, me radhë dhe vetëm sipas numrit rendor rritës të qendrave të votimit, marrin nga stiva e kutive të votimit kutitë e votimit me fletët e votimit të vetëm një qendre votimi dhe i vendosin pranë tryezës së Grupit të Numërimit përkatës. Në vijim, anëtarët e Grupit të Numërimit marrin nga sekretari i KZAZ-së modelin krahasues të vulës së kryetarit të KQV-së, të depozituar në përputhje me pikën 2 të nenit 100 të këtij Kodi”.*

Në vijim të analizës së mësipërme, Kolegji Zgjedhor vlerëson se, plotësohen kushte ligjore të parashikuara nga Neni 160 pika 1 e Kodit Zgjedhor dhe, për pasojë, zgjedhjet në Qendrën e Votimit Nr.2224/1 për Bashkinë Rrogozhinë, duhet të deklarohen të pavlefshme për shkak shkeljesh ligjore që kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor në këtë qendër.

Nga ana tjetër, sa i takon vlefshmërisë së zgjedhjeve në qendrat e tjera të votimit dhe pasojave që sjell deklarimi i pavlefshëm zgjedhjeve në vetëm një qendër votimi, Kolegji Zgjedhor vlerëson dhe merr në analizë diferencën e votave ndërmjet dy kandidatëve për kryetar bashkie në Rrogozhinë.

Sikurse evidentohet edhe në vendimin objekt padie, pas numërimit të fletëve të votimit të Qendrës së Votimit Nr.2224/1, kandidatët kanë rezultuar me 30 vota difference, por tashmë në favor të kandidatit të subjektit zgjedhor Partia Socialiste.

Pas rinumëruan dhe rivlerësuan nga KAS, të të gjitha fletëve të votimit për kandidatët për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, rezultati është ndryshuar dhe diferenca e votave të vlefshme mes kandidatëve për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, ka rezultuar nga 30 vota, në 21 vota më shumë për kandidatin e subjektit zgjedhor Partia Socialiste.

Referuar këtyre të dhënave rezulton se, në Qendrën e Votimit Nr.2224/1, votimi në të cilën konsiderohet i pavlefshëm, numri i zgjedhësve (118 zgjedhës, 94 prej të cilëve kanë votuar), ka qënë më i madh se diferenca (21 vota), midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme.

Në këtë kontekst, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor nuk përlligj përfundimin e KAS, se:

*“13. Rinumërimi dhe rivlerësimi i votave që u krye nga administrata e KQZ-së me pjesëmarrjen e vëzhguesve nga palët dhe nën mbikëqyrjen e KAS-it nuk zbuloi shkelje që mund të konsideroheshin cënim i rregullave në zbatimin e procedurës. Vetëm në një QV u konstatua tabulimi i dy votave më shumë për kandidatin e subjektit PS, gjë që kishte lidhje me pasqyrimin e parregullt në tabelë të dy votave të hedhura në kutinë e gabuar (pasqyrim i dyfishtë). KAS-i konstatoi nga këqyrja e votave të kontestuara në procesin e rinumërimit dhe rivlerësimit, se vlerësimi i votave ishte kryer nga grupet e numërimit sipas standartit dhe në përputhje me “udhëzuesin e punës për komisionet e zonave të administrimit zgjedhor dhe grupet e numërimit të votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, miratuar me vendimin nr.24, datë 05.05.2023 të Komisionit Rregullator. KAS-i e ndryshoi vlerësimin e bërë nga GNV-të vetëm **për një numër të parëndësishëm votash**, bazuar në leximin e ndryshëm dhe respektimin më adekuat të vullnetit të votuesve. Në përfundim të procedurës, diferenca e votave midis kandidatit fitues dhe kandidatit të ankuesit zbriti nga 30 në 21 vota. Tabela me rezultatin e rinumërimit dhe rivlerësimit i bashkëlidhet këtij vendimi”.*

Për sa më sipër, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor arrin në përfundimin se, pavlefshmëria e zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, në Qendrën e Votimit Nr.2224/1 (pjesë e Zonës së Administrimit Zgjedhor Nr.43), sjell ndikim në rezultatin e zgjedhjeve.

Në këto kushte, Kolegji zgjedhor vlerëson se, vërtetimi i kësaj rrethane përbën shkak ligjor të detyrueshëm që dikton përsëritjen e zgjedhjeve në Zonën e Administrimit Zgjedhor Nr.43 për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë.

Në arritjen e këtij konkluzioni Kolegji Zgjedhor referon në përmbajtjen e Nenit 161 të Kodit Zgjedhor (cituar më lart).

Në interpretim të dispozitës ligjore të mësipërme, Kolegji Zgjedhor vlerëson se, shpallja e pavlefshme e zgjedhjeve në një qendër votimi, në rastin kur kjo pavlefshmëri ndikon në rezultat, pasjell pavlefshmërinë e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore.

Kjo është pasojë e parashikuar shprehimish nga ligji dhe nuk le vend për vlerësim të ndryshëm nga KQZ apo Kolegji Zgjedhor.

Ndryshe nga pala paditëse që ka krijuar tashmë standardin e reklamimit të parregullsisve në Qendrën e Votimit Nr.2224/1 të ZAZ-Nr.43, pas miratimit të procedurave që e prodhuan parregullsinë (votimit pa vërejtje të anëtarëve të komisionit), duke kërkuar heqjen e rezultatit të kësaj qendre nga Tabela Përmbledhëse e Rezultatit, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konfirmon me vendimmarrjen e tij standardin sipas të cilit, pavlefshmëria e zgjedhjeve në një qendër



votimi, kur numri i zgjedhësve të saj është më i madh se diferenca midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme, dikton përsëritjen e zgjedhjeve.

Përfundimisht, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se, padia është pjesërisht e bazuar në ligj, vetëm sa i takon pretendimeve të saj për shkelje të rënda në zgjedhjet e zhvilluara në QV Nr.2224/1 të ZAZ Nr.43, shkelje të cilat janë vlerësuar nga Kolegji Zgjedhor se përbëjnë shkak për deklarimin e pavlefshme të zgjedhjeve në këtë qëndër votimi.

Nga ana tjetër, sa i takon pasojave që rrjedhin nga kjo pavlefshmëri, Kolegji Zgjedhor vlerëson se gjen zbatim pika 1 e Nenit 161 të Kodit Zgjedhor, duke urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore dhe jo ndryshimin e tabelës së rezultateve, sikurse është kërkuar nga pala paditëse.

Shpenzimet gjyqësore lidhur me këtë çështje përbëhen nga taksa mbi aktet në masën 30000 lekë, parapaguar nga paditësi. Shpenzime të tjera nuk u kryen dhe as u pretenduan.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në Nenin 158/1,b/3 të Ligjit Nr.10019 Dt.29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i përditësuar, me shumicë votash:

### **VENDOSI**

1. Pranimin pjesërisht të padisë.
2. Shfuqizimin e vendimit Nr.174, datë 06.06.2023 të KAS.
3. Shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve vendore të datës 14 maj 2023 në Zonën e Administrimit Zgjedhor Nr.43 për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, duke urdhëruar përsëritjen e këtyre zgjedhjeve.
4. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
5. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë, më 15.06.2023.

**GJYQTARE**  
**Marsela Dervishi**

**GJYQTARE**  
**Edlira Petri**

**GJYQTARE**  
**Blerona Hasa**

**GJYQTARE**  
**Emona Muçi**  
**(kundër)**

**GJYQTARE**  
**Esmeralda Xhili**  
**(kundër)**